

EVROPA JUGLINDORE
RAPORT I RREGULLT
EKONOMIK
NR.6

RIMËKËMBJE E
BRISHTË

maj, 2014

Falënderim

Ky Raport i Rregullt Ekonomik (RRrE) mbulon zhvillimet ekonomike, perspektivat dhe politikat në gjashtë shtetet e Evropës Juglindore (SJG6), përkatësisht në: Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi. Raporti përgatitet dy herë në vit nga stafi i ekonomistëve të Departamentit të Uljes së Varfërisë dhe Menaxhimit Ekonomik të Rajonit të Evropës dhe Azisë Qendrore të Bankës Botërore (ECA PREM). Skuadra e autorëve përfshin Gallina A Vincelette (drejtuese e grupit të punës dhe autore kryesore e raportit), Željko Bogetić (autor kryesor), Simon Davies (autor kryesor), Abebe Adugna, Agim Demukaj, Doerte Doemeland, Sandra Hlivnjak, Anil Onal, Suzana Petrovic, Lazar Sestović, Sanja Madzarević-Sujster, Hilda Shijaku dhe Bojan Shimbov. Mizuho Kida dhe Wolfgang Fengler kanë dhënë kontributin e tyre lidhur përkatësisht për zhvillimet dhe gjendjen globale dhe çështjet e sektorit financiar. Maria Andreina Clower, Christopher Pala, dhe Budy Wirasmo kanë dhënë ndihmë të çmuar në redaktimin dhe skicimin e këtij raporti.

Shpërndarja e raportit dhe marrëdhëniet me jashtë dhe me median janë menaxhuar nga skuadra e EXR-së, e përbërë nga Lundrim Aliu, Boris Balabanov, Anita Bozinovska, Ana Gjokutaj, Jasmina Hadzić, Andrew Kircher, Vesna Kostić, Mirjana Popović, John Mackedon, Kristyn Schrader-King, dhe Dragana Varezić.

Skuadra i është mirënjohëse Ellen Goldstein-it (Drejtoreshë për Shqipërinë në Departamentin e Evropës Juglindore), Roumeen Islam-it (Drejtor Sektori në Detyrë, ECA PREM), Satu Kähkönen-it (Menaxher Sektori, ECA PREM), dhe Njësisë së Menaxhimit të Evropës Juglindore për udhëzimet dhe për përgatitjen e këtij raporti. Skuadra është mirënjohëse po ashtu për komentet e marra për draftet paraprake të këtij raporti nga Bankat Qendrore dhe Ministrinë e Financave të shteteve të sipërpërmendura.

Ky raport si dhe raportet e mëparshme të RRrE-së për Evropën Juglindore mund të gjenden në adresën: www.worldbank.org/eca/seerer

Ky volum është produkt i stafit të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore. Gjetjet, interpretimet, dhe përfundimet e shprehura në këtë raport nuk reflektojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Drejtorëve Ekzekutivë të Bankës Botërore, ose të qeverive që ata përfaqësojnë. Banka Botërore nuk garanton saktësinë e të dhënave të përfshira në këtë raport. Kufijtë, ngjyrat, përcaktimet ose informacionet e tjera të përfshira në çdonjërin ndër hartat në këtë dokument nuk nënkuptojnë asnjë interpretim nga ana e Bankës Botërore lidhur me statusin ligjor të ndonjë territori, ose miratimin apo pranimin e këtyre kufijve.

E drejta e autorit:

Materiali në këtë botim është i mbrojtur nga e drejta e autorit. E drejta e autorit dhe/ose marrja e fragmenteve ose e të gjithë punës pa leje paraprake mund të përbëjë shkelje të ligjit të zbatueshëm. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim/Banka Botërore inkurajon shpërndarjen e punës së saj dhe normalisht jep leje për riprodhimin e pjesëve të raportit menjëherë.

Për leje për të bërë fotokopje, ose për të riprintuar pjesë të kësaj pune, ju lutem na dërgoni një kërkesë me informacion të plotë në adresën: Clearance Center, Inc., 222 Rosewood Drive, Danvers, MA 01923, USA, telefon 978-750-8400, faks 978-750-4470, <http://www.copyright.com/>.

Të gjitha pyetjet lidhur me të drejtat dhe licencat, duke përfshirë dhe të drejtat e prejardhura, duhet të drejtohen në adresën: Office of the Publisher, The World Bank, 1818 H Street NW, Washington, DC 20433, USA, fax 202-522-2422, e-mail pubrights@worldbank.org.

Përmbajtja e Lëndës

Përmbledhje	1
I. Zhvillimet e kohëve të fundit	7
Dalja nga recesioni	7
Rritja e mbështetur tek eksporti	11
Sfidat e vazhdueshme për trajtimin e papunësisë së lartë	16
Presionet fiskale nuk po ulen	19
Inflacioni në rënie dhe i ulët	24
Sektori financiar i qëndrueshëm, megjithëse i brishtë	27
II. Perspektivat	33
Perspektivat afatshkurtra të rritjes dhe parashikimi afatmesëm	33
Konvergimet sfiduese afatgjata	37
III. Momente të rëndësishme	43
Moment i Rëndësishëm 1. (Pa)Punësimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor	43
Moment i Rëndësishëm 2. Huatë e këqija në EJL6: efektet, pengesat që kërkojnë zgjidhje dhe reformat	47
Shtojca I: Treguesit kryesorë	53

Lista e Figurave

Figura 1: Rritja në EJL6, 2012–13	9
Figura 2: Rritja e Produktit Industrial në vitin 2012 dhe 2013	9
Figura 3: Remitancat e Punonjësve 2010–2013	9
Figura 4: Llogaritë Korrente të EJL6-ës, dhe Bilanci i Tregtisë dhe Shërbimeve	11
Figura 5: Bilanci i Llogarisë Korrente të EJL6-ës	11
Figura 6: Indeksi i Kostove Reale të Njesisë së Punës	12
Figura 7: Kontributet për Ndryshimin e Kostove për Njësi Pune që prej 2008-ës	12
Figura B2.1: Hendeqet në Importe dhe Eksporte në EJL6	13
Figura 8: Rritja e Eksporteve në EJL6 Eksport	14
Figura 9: Financimi i Llogarive Korrente të EJL6-ës	14
Figura 10: Prurjet e IHD-ve	14
Figura 11: Borxhi mesatar i Jashtëm i EJL6-ës	15
Figura 12: Borxhi i Jashtëm i Përgjithshëm Publik dhe Privat 2011–13	15

Figura 13: Indeksi i Punësimit në EJJ, BE11, BE15	16
Figura 14: Indeksi i Punësimit në Shtetet e EJJ-së	16
Figura 15: Papunësia në EJJ, BE11 dhe BE15	17
Figura 16: Papunësia, tremujori i 4-rt i 2013-ës	17
Figura 17: Ndryshimi në Punësimin e të Rinjve dhe të Rriturve	17
Figura 18: Papunësia tek të Rinjtë sipas Pasurisë	17
Figura 19: Deficitet Fiskale	19
Figura 20: Ndryshimet në të Ardhura, 2009–13	19
Figura 21: Kontributi Mesatar Drejt Ndryshimit të të Ardhurave	19
Figura 22: Tatimet mbi Tregtinë Ndërkombëtare	20
Figura 23: Tatimet e Tregtisë si % Përqindje e të Ardhurave	20
Figura 24: Shpenzimet Kapitale	21
Figura 25: Kontributi në Ndryshimin e Deficitit, 2013–14	21
Figura 26: Borxhi dhe Garancitë Publike	22
Figura 27: Inflacioni i CPI-së	24
Figura 28: Krahësimi Rajonal i Inflacionit të CPI-së	24
Figura 29: Inflacioni i Çmimeve të Ushqimeve	25
Figura 30: Inflacioni i Çmimit të Energjisë	25
Figura 31: Hendeqet e Prodhimit në EJJ6	25
Figura 32: Nivelet e Politikave Zyrtare	26
Figura 33: Furnizimi Real i Gjerë me Mjete Financiare	26
Figura 34: Financimet dhe Kostot e Financimeve për EJJ6-ën	27
Figura 35: Shpërndarja e CDS-së për EJJ6-ën	27
Figura 36: Kthimi mbi Aktivet (ROA), mesataret t0000remujore	28
Figura 37: Raporti Hua me Depozitë	28
Figura 38: Niveli i Likuiditetit	28
Figura 39: Niveli i Mjaftueshmërisë së Kapitalit	28
Figura 40: Huatë e Këqija	29
Figura 41: Nivelet e Rritjes së Kreditimit	29
Figura 42: Niveli i Rritjes Reale të PBB-së sipas Skenarit Bazë dhe Skenarit të Ulët	36
Figura 43: PBB-ja për Frymë në 2012-ën	37
Figura 44: PBB-ja për Frymë në EJJ si % e Mesatares së BE-së EU	37
Figura 45: Konvergjencia e të Ardhurave	38
Figura S1.1: Niveli i papunësisë tek të Rinjtë 2012	43
Figura S1.2: Ndryshimi në nivelin e papunësisë, 2008–12	43
Figura S1.3: Numri i të moshuarve për dhjetë persona me moshë pune	44
Figura S1.4: Ndryshimi vjetor në nivelin e papunësisë tek të rinjtë dhe të rriturit përkundrejt PBB-së	45
Figura S2.1: Huatë e Këqija Bankare	47

Lista e Tabelave

Tabela 1: Rritja për Eksportet e Mallrave	7
Tabela 2: Niveli i Borxhit Sovran	23
Tabela 3: Rritja Reale dhe Parashikimet e PBB-së	33
Tabela S2.1: Përmbledhje e Programeve dhe e Reformave në Proces e Sipër për të Trajtuar Huatë e Këqija në Ballkanin Perëndimor	48

Lista e Kutive

Kutia 1: Zhvillimet globale ekonomike	8
Kutia 2: Potencialet tregtare për EJL-në	12
Kutia 3: Perspektiva dhe rreziqet globale	35
Kutia 4: Sfidat demografike ndaj Konvergimit të të ardhurave në EJL6	39

Përmbledhje

Zhvillimet ekonomike të kohëve të fundit

Ekonomia e Evropës Juglindore (EJL6) u rimëkëmb nga recesioni i vitit 2012, duke u rritur mesatarisht me 2 përqind në vitin 2013.¹ Secili nga gjashtë shtetet e EJL6-ës ka shënuar nivele pozitive rritje në vitin 2013, me rritje në nivelin 3 përqind ose më lart në Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Mal të Zi.

Kërkesa e jashtme për eksportet e shteteve të EJL6-ës, veçanërisht nga shtetet e Bashkimit Evropian (BE) ka qenë shtytësi kryesor i rimëkëmbjes. Eksportet e EJL6-ës janë shtrirë në nivelin afër 17 përqind në vitin 2013, të kryesuara nga eksportet serbe të cilat u rritën në 25.6 përqind. Nga ana tjetër, kërkesa e brendshme e rajonit u kontraktua në një ritëm prej 1.4 përqind në vitin 2013. Me pak vende të reja pune dhe me besim të kufizuar në ekonomi, të ardhurat e familjeve dhe fitimet e kompanive e kanë pasur të pamundur të rrisin konsumin e brendshëm ose investimet në shtetet e EJL6-ës. Kërkesa e brendshme është shtypur më tej nga ulja e remitancave në EJL6 në vitin 2013, duke reflektuar ende një rimëkëmbje ekonomike të plogësht dhe një papunësi të lartë mbizotëruese në shtetet pritëse (kryesisht në BE).

Nga ana e prodhimit, shtytësi i rritjes në EJL6 kanë qenë të përzier, por një vit i mbarë bujqësor ka mbështetur aktivitetin ekonomik në të gjitha shtetet. Rritja e prodhimit në Serbi, Shqipëri dhe Bosnjë Hercegovinë është kryesuar nga industria dhe bujqësia. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë kjo rritje erdhi si rezultat i ndërtimit. Rritja e Malit të Zi erdhi si rezultat i një rimëkëmbje me bazë të gjerë.

Rimëkëmbja e drejtuar nga eksportet, e kombinuar me një kërkesë të brendshme të ulët ka çuar në ngushtim të konsiderueshëm të disbalancave të llogarive korrente të jashtme në të gjitha shtetet e EJL6-ës. Si rritja e eksporteve dhe ulja e importeve ka kontribuar në uljen e deficiteve tregtare në shtetet e EJL-së me 4.9 përqind të PBB-së dhe në deficite të llogarive korrente në 3.5 përqind të PBB-së në vitin 2013. Gjithsesi, qëndrueshmëria e kësaj rritjet të lartë të eksporteve është e pasigurt duke pasur parasysh bazën e ngushtë të eksporteve të EJL6 dhe çështjet e konkurrueshmërisë të cilat vijnë si rezultat i uljes së produktivitetit dhe rritjes së pagave reale.

Investimet e huaja të drejtpërdrejta (IHD) dhe portofoli i investimit kanë financuar pjesën më të madhe të deficiteve të llogarive korrente në EJL6. Investimet e huaja të drejtpërdrejta neto u rritën në 2.9 përqind të PBB-së. Këto investime u përqendruan kryesisht në prodhim në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në infrastrukturë në Kosovë dhe në Shqipëri.

Evropa Juglindore: Rritja Reale e PBB-së, në përqindje

	2012	2013	2014	2015
Albania	1.3	0.4	2.1	3.3
Bosnia and Herzegovina	-1.1	0.8	2.0	3.5
Kosovo	2.7	3.0	3.5	3.5
FYR Macedonia	-0.4	3.1	3.0	3.5
Montenegro	-2.5	3.5	3.2	3.5
Serbia	-1.7	2.5	1.0	1.5
SEE6*	-0.7	2.1	1.9	2.6
<i>Memo item:</i>				
Euro Area	-0.6	-0.4	1.2	1.7

Shënim: Mesatarja e ponderuar e *PBB-së. Viti 2013 është vlerësim i përafërt. 2014-a dhe 15-a janë parashikimet e stafit të Bankës Botërore.

Burimi: Banka Botërore

¹ EJL6-a përfshin këto shtete: Shqipërinë, Bosnjë dhe Hercegovinën, Kosovën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë.

Në përgjithësi shtetet e EJL6-ës kanë sukses të kufizuar për përkthimin e rimëkëmbjes ekonomike në vende pune. Me rivitalizimin e aktivitetit të kryesuar nga eksportet, nivelet e punësimit në EJL6 u rritën në vitin 2013 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe në nivel më të ulët në Bosnjë dhe Hercegovinë. Gjithsesi, nivelet e punësimit janë ende të ulëta në Serbi dhe në Shqipëri. Papunësia ka qëndruar në nivele të larta në EJL6, duke shënuar një nivel mesatar prej 24.2 përqind në vitin 2013. Nivelet e larta të papunësisë dhe niveli i lartë i papunësisë kronike është i pranishëm posaçërisht ndërmjet grupeve të cënueshme, të tillë si të rinjtë dhe personat me aftësi të ulëta.

Shtetet e EJL6 i kanë ulur deficitet e tyre fiskale në 3.8 përqind të PBB-së në vitin 2013 nga 4.3 përqind të PBB-së në vitin 2012. Me rritje të ngathët, presione deflacioniste dhe me kalimin tek rritja e mbështetur tek kërkesa nga jashtë, të ardhurat janë ndjerë nën presion, duke rënë mesatarisht me 0.5 përqind të PBB-së në vitin 2013. Por, shpenzimet u ulën mesatarisht me 1 përqind të PBB-së dhe kompensuan humbjen në të ardhura. Pavarësisht nga këto përpjekje, masat e ndjekura për konsolidimin fiskal nuk kanë qenë të mjaftueshme për të tejkaluar kufizimet ekzistuese strukturore në financat publike në shtetet e EJL6, duke përfshirë për shembull: pagat e larta publike (të barabarta mesatarisht me mbi çerekun e shpenzimeve të përgjithshme dhe me mbi 11 përqind të PBB-së në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në Serbi), përfitime sociale jo të etiketuara drejt (në mesatarisht 12.5 përqind të PBB-së), dhe shpenzime kapitale të ulëta dhe në ulje (në nën 4 përqind të PBB-së në fund të vitit 2013 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbi).

Ritmi i masave fiskale dhe rritja ekonomike ende foshnjore kanë qenë të pamjaftueshme për të tjetërsuar dinamikën e borxhit publik në vendet e EJL6. Borxhi mesatar publik, duke përfshirë garancitë, u rrit nga 47.7 përqind të PBB-së në vitin 2012 në 50.1 përqind në vitin 2013, pasi shteteve të EJL-së iu desh të merrnin hua për të financuar deficitet fiskale. Borxhi i përgjithshëm publik dhe garancitë publike mbetën në mbi 60 përqind të PBB-së në Shqipëri, Malin e Zi, dhe Serbi në fund të vitit 2013.

Në një mjedis inflacionar të ulët, bankat qendrore të shteteve të EJL6-ës kanë ndjekur politikën e lëshimit të moderuar të politikave monetare. Për të mbështetur likuiditetin dhe për të rritur aksesin në financa, bankat qendrore në Shqipëri, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Serbi i kanë shkurtuar nivelet e tyre bazë të interesit me përkatësisht 1, 0.5 dhe 1.75 pikë përqindje në vitin 2013. Duke pasur parasysh objektin e kufizuar të politikave të tyre monetare, Bosnje Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi e ulën kërkesën e tyre për rezervën në nivele të ngjashme me periudhën para krizës për të lehtësuar financimin.

Spektori financiar ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm, pavarësisht se i brishtë, gjatë vitit 2013. Megjithatë kushtet e financimit për shtetet e EJL6-ës u përmirësuan në gjysmën e dytë të vitit 2013, mungesa e mbështetjes/mosdisbursimit nga bankat e huaja vijoi. Bankat e shteteve të EJL6-ës e ruajtën likuiditetin e tyre gjatë vitit 2013 dhe kapitalet e tyre kanë qenë në nivel të mirë. Gjithsesi, aktualisht ka ende dy sfida të ndërlikshme të cilat kanë nevojë për marrjen e masave përkatëse: zbutja e huave të këqija, të cilat ende janë në rritje, dhe rifillimi i rritjes së kreditimit, në veçanti i huadhënies për investime për bizneset. Huatë e këqija janë trefishuar gjatë pesë viteve të fundit nga një mesatare prej 5 përqind në një mesatare prej 16 përqind në fund të vitit 2013, me hua të këqija mbi mesataren e rajonit në Shqipëri, Malin e Zi dhe Serbi. Huatë e këqija në rritje, prezantimi i standardeve më të shtrënguara për dhënien e kredive dhe përpjekjet e bankave për të pastruar bilancet e tyre dhe për të mbuluar kostot e kanë shtuar presionin për huadhënien dhe kanë ngadalësuar rritjen e kreditimit deri në zvarritje në të gjitha shtetet e EJL6-ës në vitin 2013.

Parashikimi

Rajoni i Evropës Juglindore parashikohet t'i nënshtrohet një rritje prej 1.9 përqind në vitin 2014 dhe 2.6 përqind në vitin 2015 në kurriz të kërkesës së jashtme. Rritja pozitive që prej mesit të vitit 2013 dhe kushtet monetare ende të përshtatshme të Eurozonës ka të ngjarë të vëjë në ndihmë rritjen e eksporteve të shteteve të EJL6-ës, pavarësisht rreziqeve të dukshme të lidhura me parashikimet e Eurozonës (të lidhura me zbatimin e ngadaltë të reformave, periudhën e tejzgjatur e inflacionit të ulët, rrezikun e deflacionit). Aktiviteti i përgjithshëm ekonomik i shteteve të EJL6-ës do të vazhdojë të jetë i dobët, duke reflektuar kërkesën e brendshme të dobët. Serbia mbetet shteti me ekonominë me rritje më të ngadaltë, ndërsa Kosova shteti me ekonominë me rritje më të shpejtë. Serbia, me ekonominë më të madhe ndër shtetet e EJL6-ës, duket se është nisur drejt një konsolidimi fiskal të konsiderueshëm për ta sjellë borxhin e saj në nivel të qëndrueshëm, gjë e cila ka të ngjarë të shërbejë si tërheqje për aktivitetin e saj ekonomik. Nga ana tjetër, rritja ekonomike në shtetet e tjera të EJL6-ës pritet të konsolidohet në vitin 2014 dhe të tejkalojë ritmin e zgjerimit ekonomik të vitit 2013 në përputhje me një kërkesë të jashtme më të fortë, me disa ulje modeste të papunësisë dhe përmirësim të kushteve të kreditimit. Rritja e Shqipërisë parashikohet në 2.1 përqind pasi likuidimi i planifikuar i pagesave të prapambetura nga qeveria pritet të injekttojë likuiditetin aq shumë të nevojshëm për sektorin privat dhe të ndihmojë në përshtetimin e rritjes. Ekonomitë e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kosovës, dhe Malit të Zi kanë njohur zhvillime në ndërtim, shërbime dhe turizëm. Në vitin 2015 Shqipëria, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia parashikohen të kenë rritje më të madhe ose të barabartë me rritjen e vitit 2014, në përjashtim të rasteve të materializimit të rreziqeve.

Politikat ekonomike mund të jetë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike në kuadrin afatshkurtër dhe afatmesëm të EJL6-ës. Konsolidimi fiskal "i zgjuar" për rritjen e ekonomisë është i mundur. Ky konsolidim mund të realizohet nëpërmjet: zbutjes së faturës të madhe të pagave të sektorit publik; përmirësimit të përqendrimit të transfertave dhe përfitimeve sociale tek personat më shumë në nevojë; realizimit të shpenzimeve produktive që trajtojnë ngërçet infrastrukturore; zgjerimit të bazës fiskale dhe përmirësimit të mbledhjes së të ardhurave. Nga ana e politikave monetare, me një inflacion shumë të ulët rajonal në nivelin e 1.2 përqind dhe me mangësitë e mbetura në prodhim, duket se ka terren për lehtësim të mëtejshëm gradual afatshkurtër të kushteve monetare në shtetet që kanë fiksuar monedhat e tyre. Gjithsesi, vëmendje i duhet kushtuar shteteve me nivele të ndryshueshme këmbimi valutor për t'u siguruar për mosvënien nën presion të nivelit të këmbimit dhe/ose mosngritjen e inflacionit në mënyrë të padëshirueshme. Përsa i përket politikave të sektorit financiar, trajtimi i nivelit të lartë të huave të këqija do të jetë shumë i rëndësishëm për të bërë të mundur rritjen e kreditimit dhe për të mbështetur sipërmarrjen dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Ka rreziqe domethënëse negative ndaj parashikimit makroekonomik për rajonin e EJL6-ës. Rreziqet e jashtme lidhen me: kërcënimin për deflacion në shtet e Eurozonës, i cili mund të zvogëlojë rritjen e tyre dhe kërkesën e jashtme për eksporte në shtetet e EJL6-ës; ritmi global në rritje i nivelit të interesit; dhe pasojat potenciale gjeo-politike të konfliktit ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës. Rreziqet e brendshme lidhen me: tensionet e brendshme social-politike të cilat rrjedhin nga nivelet e larta të papunësisë; përpjekjet e vazhdueshme për ristrukturimin e SOE-së, zgjedhjet dhe përpjekjet e pamjaftueshme për të trajtuar çështje strukturore pezull prej një kohe të gjatë në ekonomitë e shteteve të EJL6-ës. Këto rreziqe të jashtme dhe të brendshme, nëse materializohen, do të kenë ndikim negativ mbi perspektivën e zhvillimit për shtetet e EJL6-ës dhe do të ngadalësojnë rimëkëmbjen ekonomike foshnjore të rajonit. Në një rast ekstrem të përkeqësimit të madh të kushteve ekonomike për shkak të këtyre rreziqeve, produkti i rritjes në shtetet e EJL6-ës në vitin 2014 mund të ulet në më shumë se gjysmën (deri në 0.6 përqind) e parashikimit bazë (1.9 përqind); në vitin 2015, rritja do të ulej me një të tretën (1.7 përqind) krahasuar me parashikimin prej 2.6 përqind).

Në kuadrin afatmesëm deri në afatgjatë, arritja e standardeve të jetesës së BE-së kërkon dekada përpjekjesh të qëndrueshme nga shtetet e EJJL6-ës për të përmirësuar performancën e politikave, performancën institucionale dhe ekonomike. Rritja e të ardhurave në EJJL6 nënkupton përshpejtimin e ritmit të reformave dhe, ajo çfarë është dhe më e rëndësishme, tjetërsimin e përfitimeve të tyre në rritje ekonomike të shëndetshme dhe të barabartë. Heqja e pengesave strukturore jo vetëm në përzierjen e politikave makroekonomike, por edhe rritja e integritit global dhe e lidhjes ndërmjet shteteve të EJJL6-ës, përmirësimi i potencialit produktiv dhe i konkurrueshmërisë së ekonomisë, forcimi i institucioneve do t'i japin përfundimisht një shtytje të fortë rritjes së të ardhurave dhe konvergimit.

I. Zhvillimet e kohëve të fundit

Dalja nga recesioni

Shtetet e EJL6-së dolën nga recesioni në vitin 2013 me rritjen ekonomike të mbështetur nga rimëkëmbja në shtetet me të ardhura të larta, veçanërisht në shtetet e Bashkimit Evropian (BE). Pas një ulje prej 0.7 përqind në vitin 2012, PBB-ja mesatare e përgjithshme në shtetet e EJL6-ës u rrit me 2 përqind në vitin 2013 (Figura 2). Të gjitha gjashtë shtetet e EJL6-ës kanë shënuar hapa pozitive, me rritje në nivelin 3 përqind ose më lart në Kosovë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Mal të Zi. Vetëm në Shqipëri rritja ekonomike u ngadalësua në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012, megjithëse kjo rritje mbeti pozitive. Kërkesa e jashtme për shtetet e EJL6-ës mbeti shtytësi kryesor i rimëkëmbjes ekonomike, duke reflektuar përmirësimin e ekonomisë evropiane dhe globale (shih Kutinë 1).²

Tabela 1: Rritja e Eksporteve të Mallrave, (në milionë euro)

	2012	2013	Ndryshimi në %
ALB	1,526	1,731	13.4
BIH	2,582	2,807	8.7
KOS	287	305	6.3
MKD	3,107	3,206	3.2
MNE	392	403	2.8
SRB	8,726	10,956	25.6
SEE6	16,620	19,408	16.8

Burimi: Vlerësime të Bankave Kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Nga ana e kërkesës, rimëkëmbja ekonomike u mbështet tek eksportet. Rimëkëmbja graduale në Eurozonë ndihmoi zgjerimin e eksporteve të mallrave të shteteve të EJL6-ës në thuajse 17 përqind (Tabela 1). Eksportet e Serbisë u rritën me 25.6 përqind në vitin 2013 krahasuar me vitin 2012 (të drejtuara nga eksportuesit e kompanive të huaja, të tillë si FIAT-i, Gazprom-i, Michelin-i, dhe Stada). Edhe eksportet tregtare janë rritur në të gjithë rajonin nga 2.8 përqind në Malin e Zi në 13.4 përqind në Shqipëri, ndërsa eksportet e shërbimeve kanë qenë më të ulëta se eksportet tregtare.

Me nivel papunësie ende të lartë dhe me rimëkëmbje të ngadaltë kreditimi,

kërkesa e brendshme në shtetet e EJL6-ës në vitin 2013 ka mbetur nën tryzni. Me pak vende pune dhe me kreditim të kufizuar për bizneset dhe për familjet, fitimet dhe të ardhurat e familjeve nuk kanë qenë në gjendje të nxisin konsumin e brendshëm ose investimet. Kërkesa e brendshme u kontraktua në 1.4 përqind. Me përjashtimin e Malit të Zi, rritja në kërkesën e brendshme reale ishte negative në rajon, duke shënuar zbritje në Serbi (-2.2 përqind), Bosnjë dhe Hercegovinë (-1.4 përqind), Shqipëri (-0.6 përqind) dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (-0.6 përqind).³ Në Serbi konsumi i brendshëm dhe investimet kanë dhënë një kontribut të madh negativ në rritjen e PBB-së me rreth përkatësisht 1.5 dhe 1.7 pikë përqindje. Të dhënat tremujore për PBB-në për Serbinë dhe treguesit më të gjerë në të gjithë rajonin, të tilla si kreditë, pagat, inflacioni, papunësia, importet, dhe borxhet e familjeve të gjitha sugjerojnë se kërkesa e brendshme ka qenë e shtypur dhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2014.

² Rritja ekonomike është parashikuar me 1.8 përqind në Raportin e Rregullt Ekonomik për Shtetet e EJL6-ës nr. 5, dhjetor 2013.

³ Të dhënat për kërkesën reale të brendshme të marra nga IMF WEO. Këto të dhëna nuk janë dhënë për Kosovën.


Kutia 1: Zhvillimet ekonomike globale

Rimëkëmbja e rritjes ekonomike ka qenë në drejtimin e duhur në tremujorin e parë të vitit 2014, kryesisht për shkak të përmirësimit të ndjeshëm të situatës në shtetet me të ardhura të larta. Në Shtetet e Bashkuara, pas një ulje të lehtë në dy muajt e parë të vitit, të dhënat tregojnë se ekonomia po përshpejtohet sërish pas një dimri me ngrica të mëdha. Paralelisht me rritjen më të madhe të vendeve të reja të punës (me rreth 2.4 milionë vende pune të hapura që prej fillimit të vitit 2014), rritja e rezervës dhe e çmimeve të shtëpive po nxisin rritjen dhe pasurimin e familjeve, teksa po forcohet po ashtu besimi i konsumatorit dhe niveli i shpenzimeve. Në Eurozonë, të dhënat për Indeksin e Menaxherëve të Blerjes për muajin janar dhe shkurt tregojnë për aktivitete rimëkëmbje në Gjermani, të cilat shtrihen kudo tjetër përveçse në Francë, ku pavarësisht nga kjo besimi është në rritje. Indeksi i prodhimit në Eurozonë është rritur në mars shumë afër nivelit të tij më të lartë në thuajse tre vitet e fundit. Por, kapaciteti domethënës i papërdorur dhe inflacioni konstant i ulët në të gjithë Eurozonën po shkaktojnë shqetësime reale mbi deflacionin. Në Japoni, rimëkëmbja nga shtysat e brendshme kanë çuar në rritje të produktit industrial me 12 përqind (3m/3m saar) në shkurt, që përbën dhe rritjen më të fortë që prej rimëkëmbjes pas tërmetit dhe cunamit të vitit 2011. Rritja e konsumit privat si përgjigje ndaj rritjes së taksës së konsumit në prill duhet të nxisë rritjen në tremujorin e parë të vitit 2014, por tërheqja nga rritja e taksave pa përcaktuar stimuj të mëtejshëm fiskalë dhe monetarë ka të ngjarë të ngadalësojë ritmin e rimëkëmbjes. Në shtetet në zhvillim, rritja e produktit industrial është dobësuar, pavarësisht nga rritja e eksporteve, duke reflektuar kryesisht dobësi në Brazil, Kinë dhe Indi. Performanca industriale me mungesë vitaliteti është në kontrast me eksportet nga shtetet në zhvillim, të tilla si Kina, e cila u rrit në tremujorin e fundit të 2013-ës dhe vijoi me ritmin vjetor të rritjes prej 8 përqind tre muaj para janarit. Zbutja e prodhimit industrial reflekton pjesërisht pengesat lidhur me kapacitetin ndërmjet shteteve të mëdha me të ardhura mesatare, por kohët e vështira financiare, shtrëngimet e politikave monetare dhe çmimet e ulëta të mallrave kanë kontribuar po ashtu në ngadalësimin e aktiviteteve të brendshme.

Rezerva Federale filloi të prekte programin e Lehtësisë Sasiore në janar, për shkak të parashikimeve për përmirësim të rritjes në ekonominë e Shteteve të Bashkuara. Reagimi i tregjeve financiare ishte fillimisht i dobët, me jildet e Thesarit të Shteteve të Bashkuara në gjendje të qëndrueshme dhe me vitalitetin e ulët të tregjeve të këmbimit, duke sugjeruar reflektimin e konsiderueshëm të ndikimit nga prekja e rezervës. Qetësia u prish në fund të janarit kur monedha argentinase, peso, u zhvlerësua menjëherë, shqetësimet për ekonominë kineze u rritën, ndërkohë që rol luajtën dhe faktorë të tjerë ekonomikë dhe politikë specifikë për vendin. Prurjet e kapitalit bruto në vendet në zhvillim dhe në rimëkëmbje arritën një rekord të ri të ulët në shkurt. Tregjet valutore dhe monedhat në disa ekonomi në zhvillim u vunë nën presion, ndërkohë që disa ekonomi të mëdha me të ardhura mesatare ndërmorën shtrëngime agresive politikash për të hequr stresin mbi monedhat e tyre dhe mbi inflacionin e brendshëm, përkatësisht në Argjentinë, Brazil, Indi, Indonezi, Turqi dhe Afrikën e Jugut. Ndërkohë që prurjet kapitale në ekonomitë në zhvillim dhe në rimëkëmbje e morën veten në mars, ato vijojnë të jenë të ndjeshme ndaj zhvillimeve globale. Investimet e huaja të drejtpërdrejta (të cilat mbulojnë rreth 60 përqind të prurjeve të përgjithshme) mbeten forma më e konsiderueshme dhe më pak e prekshme e prurjeve kapitale, duke i stabilizuar prurjet e përgjithshme financiare në vendet në zhvillim.

Rritja e tensionit në Ukrainë dhe Rusi që prej fundit të shkurtit ka shkaktuar deri tani ndikime relativisht të kufizuara në tregjet globale financiare, përveçse në tregun e drithërave. Indeksi VIX, një instrument matës i rrezikut global u rrit me 14 përqind, ndërsa çmimet e arit, një instrument matës për rrezikun gjeopolitik, u rritën deri me 15 përqind deri në mes të marsit, por të dy këto indekse janë ulur më pas. Çmimet e grurit dhe të misrit janë rritur përkatësisht me 17 dhe me 12 përqind, që prej shkurtit, duke reflektuar pjesërisht shqetësimet e tregut në rrethinat e Ukrainës dhe të Rusisë si dhe për shkak të motit të thatë në Amerikën e Veriut, në Amerikën e Jugut dhe pak më në Azinë Juglindore.

Figura 1: Remitancat e Punonjësve 2010–2013, (% e PBB-së)



Burimi: Bankat Qendore të EJL6-ës.

Shënim: Shqipëria, Kosova, dhe Bosnjë-Hercegovina i përkufizojnë remitancat si burime ku përfshihet dhe kompensimi i punonjësve; Serbia dhe Mali i Zi përdorin përkufizime më të ngushta. Të dhënat nga Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë përfshijnë vetëm remitancat nga punonjësit që vijnë nëpërmjet kanaleve të bankave zyrtare, siç raportohen, por jo të gjitha transfertat private.

Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (në nivelin 3.1 përqind), rritja erdhi për shkak të ndërtimit. Rritja e Malit të Zi (në nivelin 3.5 përqind) erdhi si rezultat i një rimëkëmbje me bazë të gjerë.

Në të gjitha shtetet e EJL6-ës, aktiviteti ekonomik u mbështet nga një vit i mbarë bujqësor. Pas një rënie prej 17 përqind në Serbi në vitin 2012, prodhimi bujqësor u rrit me 20 përqind në vitin 2013. Edhe shtete të tjera kanë parë rigjallërim të sektorëve të tyre bujqësorë, megjithëse në nivele më modeste. Edhe shtetet e tjera përjetuan një rimëkëmbje të sektorëve të tyre bujqësorë, megjithëse me një ritëm më të ulët.

Ndryshe nga viti 2012, prodhimi industrial i shteteve të EJL6-ës u rrit në të gjithë rajonin në vitin 2013 (Figura 3). Rritja industriale në Malin e Zi u inkurajua nga rigjallërimi i energjisë së prodhuar nga hidrocentralet dhe në Serbi nga fabrika e re e prodhimit e FIAT-it. Aktiviteti industrial është rritur dhe gjetkë në EJL6, por me ritme më të ulëta.


Të dhënat nga dy muajt e parë të vitit 2014 tregojnë se industria vijoi të rritej në të gjithë rajonin, megjithëse jo me ritëm të njëtrajtshëm. Të dhënat e disponueshme për katër shtete tregojnë se prodhimi industrial u rrit mesatarisht me 4.7 përqind gjatë dy muajve të parë të vitit 2014 (y-o-y). Siç pritej, pas kapërcimit fillestar në eksportin e makinave, prodhimi industrial i Serbisë u rrit me 1.2 përqind. Nga ana tjetër, Mali i Zi dhe Bosnjë Hercegovina shënuan rritjen më të madhe të prodhimit industrial ndërmjet shteteve të EJL6-ës (kryesisht për shkak të prodhimit) përkatësisht me 6.5 dhe 6.7 përqind rritje.

Ulja e remitancave në shtetet e EJL6-ës ka kontribuar në kërkesën e brendshme të ulët.

Remitancat në EJL6 në vitin 2013 janë ulur në raport me PBB-në, duke reflektuar rimëkëmbje të ngathët ekonomike dhe mbizotërimin e nivelit të lartë të papunësisë në shtetet e BE-së. Remitancat në rajon janë ulur me 0.5 pikë përqindje në raport me PBB-në (Figura 3). Ulja është lidhur me kushtet ekonomike me të cilat janë hasur emigrantët në vendet pritëse. Rënia më e madhe vijoi të ishte në Shqipëri, ku përmasa e kontraktimit u vlerësua në 2.2 përqind të PBB-së si rezultat i shumë emigrantëve të kthyer nga Greqia.


Nga ana e prodhimit, shtytësit e rritjes në shtetet e EJL6-ës ishin të përzier. Rritja e prodhimit në Serbi (në nivelin 2.5 përqind), Shqipëri (në nivelin 0.4 përqind) dhe në Bosnjë Hercegovinë (në nivelin 0.8 përqind) u kryesua nga industria dhe nga bujqësia, ndërkohë që në

Figura 2: Rritja në EJL6, 2012-13



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave, vlerësime të Bankës Botërore.

Figura 3: Rritja e Prodhimit Industrial në vitin 2012 dhe 2013, në %




Burimi: Zyrtar Kombëtare të Statistikave.

Rritje e mbështetur tek eksporti


Rimëkëmbja e mbështetur tek eksporti, e kombinuar me kërkesën e brendshme të ulët, çoi në një ngushtim domethënës të disbalancave të llogarive korrente në të gjitha shtetet e EJL6-ës. Rritjet në eksporte dhe uljet në importe e ulën deficitin tregtar në 4.9 përqind të PBB-së dhe bilancet e llogarive korrente në 3.5 përqind të PBB-së në vitin 2013 (Figura 4, Figura 5). Eksportet drejt vendeve të BE-së u rritën fuqimisht, veçanërisht në Bosnjë dhe Hercegovinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Serbi. Mallrat e tregtuara përbënin pjesën më të madhe të eksporteve nga shtetet e EJL6-ës, pasuar nga makineritë dhe pajisjet e transportit. Bashkërisht ato përbënë mbi 60 përqind të eksporteve të rajonit në vitin 2013. Rritja kryesore në vitin 2013 ka ardhur nga eksportet e makinerive dhe të pajisjeve të transportit, kryesisht nga Serbia. Po ashtu, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë eksportet u rritën në kurriz të makinerive dhe pajisjeve të transportit, si dhe të materialeve kimike. Eksporti i mineraleve që shërbejnë si lëndë të djegshme ka qenë gjithashtu i konsiderueshëm në Shqipëri dhe në Malin e Zi, ndërkohë që metalet bazë kanë zënë rreth çerekun e volumit të eksporteve nga Kosova në vitin 2013.

Figura 4: Llogaria Korrente e Kombinuar dhe Bilancet e Tregtisë dhe Shërbimeve në EJL6 (% e PBB-së)



Burimi: Llogaritjet e Bankave qendrore, FMN-ës, dhe Bankës Botërore.

Figura 5: Bilanci i Llogarive Korrente të EJL6-ës (% e PBB-së)



Burimi: Bankat Qendrore të EJL6-ës.

Shënim: Përmirësime në MNE CAD ndodhin çdo vit në tremujorin e tretë për shkak të sezonit kryesor turistik, duke prodhuar një CAD goxha më të ulët vjetor.

Ulja e produktivitetit dhe rritjet në pagat reale në disa prej shteteve të EJL6-ës kanë fryrë kostot e punës për njësi dhe kanë dëmtuar konkurrueshmërinë. Kostot reale të punës për njësi janë rritur që prej vitit 2008 në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi, dhe Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë (Figura 6). Rritja reale e pagës ka qenë përpjesëtimore me rritjen e produktivitetit vetëm në Shqipëri, ndërsa në Malin e Zi, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë pagat reale janë rritur pavarësisht uljes së produktivitetit (Figura 7). Serbia është i vetmi vend që ka shënua në mënyrë të qëndrueshme ulje të kostove të punës për njësi, duke mbështetur konkurrueshmërinë e saj. Pjesërisht si rezultat i situatës së

shpjeguar më sipër, eksportet nga shtetet e EJT6-ës në BE kanë mbetur goxha nën potencialin e tyre (shih Kutinë 2).

Kutia 2: Potenciali Tregtar për EJT-në

Teoria tregtare parashikon se prezantimi i një zone të tregtisë së lirë duhet të kontribuojë për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal. Për shtetet e EJT-së, CEFTA (Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore) mund të jetë po ashtu një pjesë e rëndësishme e arritjes së një tranzicioni më të butë dhe e pranimit në BE. Një vlerësim empirik bazuar në modelet e gravitetit⁴ sugjeron që pjesëmarrja në CEFTA në periudhën nga viti 2006 deri në vitin 2012 ka pasur një ndikim domethënës pozitiv mbi prurjet tregtare të EJT-së, duke rritur eksporteve nga shtetet e EJT-së tek anëtarët e CEFTA-s me rreth 72 përqind në periudhën kohore të përmendur më sipër. Në përgjithësi, rezultatet sugjerojnë se eksportuesit e EJT-së po shfrytëzojnë mundësitë e ofruara nga marrëveshja e tregtisë së lirë.

Megjithatë, pavarësisht nga përfitimet e ofruara nga CEFTA, tregtia ndërmjet shteteve të EJT-së dhe BE-së duket ende nën nivelin potencial.


- Importet nga BE-ja janë vlerësuar të jenë nën potencial në nivelin nga 18 deri në 33 përqind, në varësi të shtetit. Importet më të ulëta se potenciali mund të nënkuptojnë që firmat dhe konsumatorët paguajnë më shumë për mallra të prodhuara në vend sesa për mallrat e importeve, duke cenuar konkurrueshmërinë dhe duke ulur fuqinë blerëse të konsumatorit.
- Eksportet janë po ashtu nën potencial. Eksportet e Shqipërisë drejt BE-së vlerësohen në 40 përqind nën potencial, duke shënuar kështu nivelin më të lartë për këtë zë në EJT. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Bosnjë-Hercegovina janë në rreth 33 përqind nën potencialin e tyre, ndërsa eksportet e Malit të Zi, Serbisë dhe Kosovës janë rreth 27 përqind më pak drejt BE-së sesa potenciali i vlerësuar.

Rritja e tregtisë me BE-në mund të ndihmojë në nxitjen e punësimit dhe rritjes, si dhe në trajtimin e disbalancave makroekonomike.

- Mesatarisht, eksportet vlerësohen të jenë akoma më poshtë potencialit sesa importet. Për pasojë, trajtimi i të dyjave do të ndihmonte për trajtimin e deficiteve të mëdha të llogarive korrente që kanë pjesa më e madhe e shteteve në rajon.
- Rritja e mundësive për eksport do të nxiste prodhimin e brendshëm dhe rritjen ekonomike nëpërmjet kanalit të eksportit neto.
- Eksportet më të larta mund të çojnë po ashtu në më shumë mundësi për vende të reja pune në firmat eksportuese.

Çfarë mund të bëhet për t'i ndihmuar shtetet e EJT-së të arrijnë potencialin e tyre të eksportit? Mjediset e dobëta të biznesit në shumë shtete të EJT-së i pengojnë rritjen e qëndrueshme dhe eksportet. Për shembull, nevojiten më shumë rregulla dhe rregullore tregtie.

Figura B2.1: Boshllëku ndërmjet Importeve dhe Eksporteve në EJT6, (% e Importeve dhe Eksporteve Potenciale, përkatësisht, për periudhën 2006-12)



Burimi: Vlerësime të stafit të Bankës Botërore

përmirësuar mjedisin e biznesit dhe atë tregtar, si dhe ndërtimi i institucioneve që krijojnë mundësi për bizneset lokale për


Sondazhi i Të Bërit Biznes konstaton se nevojitet kohë e konsiderueshme për të bërë eksporte në të gjitha shtetet e EJT-së. Duhet 12 ditë për të eksportuar në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Serbi, 14 ditë në Malin e Zi, 15 ditë në Kosovë, 16 ditë në Bosnjë-Hercegovinë dhe 19 ditë në Shqipëri. Të siguruarit e respektimit të standardeve të sigurisë së BE-së për prodhim të certifikuar (p.sh. bujqësi) mund të ndihmojë në nxitjen e eksporteve në tregjet e BE-së. Lidhja më e mirë nëpërmjet transportit mund të jetë po ashtu e rëndësishme. Për shembull, marrja e masave për ta bërë Lumin Sava të lundrueshëm për anijet me përmasa mesatare mund të çojë në përmirësim të situatës.

Është e shpjegueshme të presësh që shtetet e EJT-së të integrohen më shumë në ekonominë e BE-së, sikur edhe për faktin që të gjitha shtetet janë candidate potenciale për anëtarësim në BE. Ndryshimet strukturore për të

⁴ Modelet e gravitetit vlerësojnë potencialin tregëtar ndërmjet shteteve ose rajoneve bazuar në PBB-të e tyre, afërsinë dhe karakteristikat e përbashkëta, të tilla si gjuha ose sistemet ligjore.

të përfituar nga tregëti më e lirë do t'i lejojnë shteteve të Ejl-së të përfitojnë si nga afërsia gjeografike edhe nga aj ekonomike me BE-së.


Figura 6: Indeksi i Kostove Reale të Punës për Njësi (2008=100)



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave, vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Shënim: 2009-a reflekton një shpërndarje strukturore në të dhënat e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë për shkak të rishikimeve të metodologjisë në përkufizimet e pagave neto.


Figura 7: Kontributet në Ndryshimin e Kostove të Punës për Njësi që prej 2008-ës (në pikë përqindje)



Burimi: Vlerësime të Zyrtare kombëtare të statistikave dhe të stafit të Bankës Botërore.


Struktura e financimit e deficiteve të llogarive korrente (CAD) është përmirësuar (Figura 8), me pjesën më të madhe të financimit që ka ardhur nga investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe nga portofoli i investimeve. Investimet e drejtpërdrejta kanë përbërë burimin më të madh të financimit në vitin 2013, duke mbuluar thuajse dy të tretat e financimit të deficitit të llogarive korrente (Figura 9). Përqindja e Investimeve të Huaja të Drejtpërdrejta në financimin e deficitit të llogarisë korrente është rritur ndjeshëm nga 18.4 përqind në vitin 2012 në 63 përqind në vitin 2013. Efekti më i madh ishte ai në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, i ndjekur nga rreth 87 përqind e deficitit të llogarive korrente në Shqipëri, mbi dy të tretat në Kosovë dhe në Malin e Zi, rreth gjysmën në Serbi dhe një të tretën në Bosnjë-Hercegovinë (e cila u përball me një ulje të rëndësishme në gjysmën e dytë të vitit). Portofoli i investimeve ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm në financimin e deficitit të llogarive rrjedhëse në Serbi, por ka pasur efekt negative në pjesën më të madhe të shteteve, përveçse në Malin e Zi. Investimet dhe asetet e tjera rezervë kanë shënuar ulje.

Figura 8: Rritja e Eksportit të EJL6-ës (%)



Burimi: Vlerësime të Bankave Qendrore, IMF WEO, dhe të stafit të Bankës Botërore.

Figura 9: Financimi i Llogarisë Korrente të EJL6-ës




Burimi: Vlerësime të Bankave Qendrore, IMF WEO, dhe të stafit të Bankës Botërore.

Investimet e Huaja të Drejtpërdrejta (IHD) neto janë rritur në katër shtete në vitin 2013, pavarësisht niveleve të ulëta (Figura 10). Mesatarja rajonale bruto është rritur me 1 pikë përqindje të PBB-së duke shkuar në 35.6 përqind rritje. Në Malin e Zi u shënua një ulje prej 5.1 pikë përqindje të PBB-së (me një të tretën), megjithëse Mali i Zi ishte shteti me rezultatet më të larta për tërheqjen e IHD-ve ndërmjet shteteve të

EJL6-ës me nivel IHD-je në 9.6 përqind të PBB-së, të përqendruar kryesisht në pasuritë e patundshme. Një ulje më e madhe e daljeve krahasuar me prurjet çoi në rritjen e IHD-ve neto në Serbi.

Prurjet e IHD-ve në EJL6 në vitin 2013 janë rritur lehtë me 2.9 përqind të PBB-së, duke e tejkaluar nivelin e shteteve të BE11⁵ me 2.6 përqind, por kanë mbetur shumë më pas performancës së shteteve të BE15-ës⁶ me 14 përqind të PBB-së (Figura 10). Prurjet në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, kryesisht në prodhim, janë rritur më shumë se dy herë në vitin 2013, megjithëse nga një bazë shumë e ulët. Në Kosovë dhe në Shqipëri, prurjet e IHD-ve janë rritur dhe janë drejtuar kryesisht drejt projekteve infrastrukturore, në aeroportin e Prishtinës dhe në hidrocentrale. Prurjet kanë qenë negative në tri shtetet e tjera.

Figura 10: Prurjet e IHD-ve, (% e PBB-së)



Burimi: Bankat Qendrore të EJL6-ës dhe Eurostat-i


Pavarësisht uljes së lehtë në vitin 2013, borxhi i jashtëm i shteteve të EJL6-ës ka mbetur sërish i lartë. Borxhi i jashtëm i përgjithshëm në shtetet e EJL6-ës është ulur me rreth 3 pikë përqindje në 63.5 përqind të PBB-së në vitin 2013, kryesisht për shkak të uljes së konsiderueshme të Serbisë (8.3 pikë përqindje) (Figura 11 dhe Figura 12). Moslëvrimi i sektorit privat çoi në uljen e borxhit të jashtëm rajonal në vitin 2013. Borxhi i jashtëm është rritur pak në Shqipëri për shkak të rritjes së borxhit nga sektori privat dhe rritjes së ulët e PBB-së (Figura 12).

Figura 11: Borxhi i Jashtëm Mesatar në EJL6 (% e PBB)

Figura 12: Borxhi i Përgjithshëm Publik dhe Privat 2011-13 (% e PBB-së)


⁵ Shtetet e BE11-ës janë: Bullgaria; Kroacia; Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia

⁶ Shtetet e BE15-ës janë: Austria; Belgjika; Danimarka; Finlanda; Franca; Gjermania; Greqia; Irlanda; Italia; Luksemburgu; Holanda; Portugalia; Spanja; Suedia; dhe Mbretëria e Bashkuar.



Burimi: Bankat Qendrore të EJT6-së dhe ministratë e tyre të financave.

Shënim: Pjesa me të gjejë përfaqëson normën e Maastrichtit për nivelet e borxhit.



Burimi: Bankat Qendrore të EJT6-së dhe ministratë e tyre të financave; FMN; Banka Botërore.


Shënim: Borxhi i jashtëm i MNE-së është thekshtë vlerësim i përafërt. Po ashtu borxhi i jashtëm privat i Kosovës është po ashtu vlerësim i përafërt dhe mund të jetë pak i nënvlerësuar. Borxhi i saj i jashtëm përjashton po ashtu borxhin potencial ndaj Klubeve të Londrës dhe të Parisit, i cili duhet të negociohet me Serbinë.

Sfidat e vazhdueshme për trajtimin e papunësisë së lartë


Me rimëkëmbjen e aktiviteteve, nivelet e punësisë në EJT6 janë rritur pak në vitin 2013. Sipas Sondazheve të Krahut të Punës, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi dhe, në nivel pak më të ulët edhe Bosnja dhe Hercegovina, kanë përjetuar rritje në punësim. Megjithatë, këto rritje punësimi reflektojnë performancën ekonomike afatshkurtër dhe nuk mund të lenë gjurmë në nivelet e larta të papunësisë dhe në nivelet e ulëta të pjesëmarrjes së krahut të punës. Nivelet mesatare të punësimit afatgjatë (si dhe të papunësisë) kanë vijuar të dëshmojnë kushte të këqija të tregut dhe të produkteve të punës. (Figura 13, Figura 14).

Figura 13: Indeksi i Papunësinë në EJT, BE11, BE15 (2008=100)

Figura 14: Indeksi i Nivelit të Pjesëmarrjes së Krahut të Punës në EJT, BE11, BE15 (2008=100)




Burimi: Vlerësime të Zyrtare Kombëtare të Statistikave dhe të stafit të Bankës Botërore.



Burimi: Vlerësime të Zyrtare Kombëtare të Statistikave dhe të stafit të Bankës Botërore.

Pavarësisht rritjes së punësimit, nivelet e papunësisë në fund të vitit 2013 ishin ende të larta në nivelin 24.1 përqind. Niveli i papunësisë së rajonit është gjerësisht më i madh se në vendet e BE11-ës dhe BE15-ës (Figura 15).⁷ Në të gjitha shtetet përveç Shqipërisë dhe Kosovës⁸ niveli i papunësisë ka filluar të ulet që pas kulmit të krizës dhe në disa raste është ulur dhe edhe më poshtë se niveli para krizës (Figura 16).


Figura 15: Papunësia në EJT, BE11 dhe BE15 (% krahut të punës)



Shënim: AMesataret vjetore të ponderuara nga krahu i punës.

Burimi: Të dhënat e shteteve të LFS-së, Eurostat.

Figura 16: Papunësia, 3M4 2013 (% e krahut të punës)



Burimi: Zyrtar kombëtare të statistikave, vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Shënim: 2009-a reflekton një shkëputje strukturore në të dhënat për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë për shkak të rishikimeve në metodologji në përcaktimin e pagave bruto.

VI | Papunësia afatgjatë (e përcaktuar si papunësi që zgjat për më shumë se 12 muaj) ka vijuar të rritet që prej fillimit të krizës financiare. Kriza globale financiare dhe recesioni pasues i dyfishtë në

⁷ Shtetet e BE11-ës janë: Bullgaria; Kroacia; Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia; Shtetet e BE15-ës janë: Austria; Belgjika; Danimarka; Finlanda; Franca; Gjermania; Greqia; Irlanda; Italia; Luksemburgu; Holanda; Portugalia; Spanja; Suedia; dhe Mbretëria e Bashkuar.


⁸ Të dhënat më të fundit të disponueshme për Kosovën i përkasin vitit 2012.

shtetet e EJL6-ës e kanë bërë të vështirë që personat që e kanë humbur vendin e punës të mund të gjejnë një vend të ri pune. Përqindja e papunësisë afatgjatë ndërmjet të papunësuarve ka qenë në nivele goxha të larta në 83 përqind të papunësisë në Bosnjë dhe Hercegovinë, 82 përqind në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, 76 përqind në Serbi, 72 përqind në Shqipëri dhe 60 përqind në Kosovë.

Në të gjithë rajonin, nivelet e papunësisë tek të rinjtë janë goxha më të larta se niveli i papunësisë në përgjithësi (Figura 17).⁹ Në fund të vitit 2012, niveli i përgjithshëm i papunësisë në shtet e EJL6-ës ishte rritur me afërsisht 5 pikë përqindje krahasuar me nivelet para krizës. Nivelet e papunësisë tek të rinjtë u rritën me dy herë më tepër. Të dhënat e sondazhit të familjeve tregojnë se nivelet e papunësisë tek të rinjtë janë përgjithësisht më të larta për segmentet më të varfra të shpërndarjes së të ardhurave (Figura 18) për shkak se të rinjtë varen më shumë nga të ardhurat nga puna për të jetuar. Sa më e gjatë të jetë kjo papunësi, aq më shumë ajo forcon pabarazitë në të ardhura dhe pengon përmirësimet në prosperitetin e përbashkët. Për më tepër, kushtet e vështira të tregut të punës janë përkthyer në ulje të pjesëmarrjes së krahut të punës dhe në rritje të shkëputjes së të rinjve nga tregu i punës. Rritjet në numrin e personave që nuk janë as të regjistruar në ndonjë institucion arsimor, as të punësuar dhe as të trajnuar e ilustron këtë argument. Personat me aftësi të ulëta, pra personat që nuk kanë më shumë se arsimin e mesëm, kanë qenë objekt i rritjes së papunësisë në të gjithë rajonin e EJL6-ës. (Shih Momentin e Rëndësishëm 1 për më shumë informacion lidhur me punësimin e të rinjve.)

Figura 17: Papunësia tek të Rinjtë dhe të Rriturit, 2008-2012


change in unemployment rate, 2008-12 (percentage points)



Burimi: Eurostat, zyrat kombëtare të statistikave

Figura 18: Papunësia tek të Rinjtë sipas Nivelit të të Ardhurave

percent




Burimi: Sondazhet për Buxhetin e Familjeve

VI | CONTENTS
Një raport i ri i Bankës Botërore (i planifikuar për vitin 2014) për vendet e punës për të rinjtë përshkruan karakteristikat kryesore të të rinjve në Evropë. Për më tepër, raporti shqyrton fenomenin e “ciklit” të dukshëm të punësimit tek të rinjtë, duke u përpjekur të kuptojë sesi ndryshon ai në pjesë të ndryshme të kontinentit dhe në pika të ndryshme të ciklit (pra bumet k. recesioneve). Ai sheh po ashtu përtej ndikimeve të rritjes së PBB-së dhe shqyrton politikat dhe institucionet specifike të cilat kanë ndikim mbi dinamikat e punësimit tek të rinjtë, në veçanti mungesat e stimuljeve dhe pengesat ndaj punësimit, të cilat mund t’i mbajnë të rinjtë jashtë punësimit dhe aktivitetit produktiv.

Presioni fiskal nuk po ulet

Ndërkohë që deficitet fiskale janë ulur në vitin 2013, situata fiskale në EJL6 nuk mund të jetë e qëndrueshme në qoftë se shtetet nuk i trajtojnë kufizimet strukturore në shpenzimet e tyre. Mesatarisht, shtetet anëtare të EJL6-ës kanë ulur deficitet e tyre fiskale në vitin 2013 falë kontrollit më të ngushtë të shpenzimeve. Deficiti fiskal mesatar i panponderuar¹⁰ ra me 3.8 përqind të PBB-së në vitin 2013 nga 4.3 përqind të PBB-së në vitin 2012 (Figura 19). Me rritjen e ngadaltë, presionet deflacioniste dhe kalimin tek rritja e mbështetur në kërkesën e jashtme, të ardhurat kanë rënë nën presion, duke rënë mesatarisht me 0.5 përqind të PBB-së. Por shpenzimet e shtrënguara, të cilat janë ulur mesatarisht me 1 përqind, e kanë kompensuar (madje dhe më shumë) uljen e të ardhurave.

Figura 19: Deficitet fiskale, % GDP



Burimi: Përlogaritje e Autoriteteve Kombëtare dhe e Stafit të Bankës Botërore.



kanë rënë në mënyrë të vazhdueshme që prej vitit 2006 (Figura 22). Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA) me BE-në të përmbyllura në periudhën nga viti 2007 deri në vitin 2013 u kanë kërkuar shteteve të EJL6-ës të ulin pengesat e tregtisë, duke ulur faturat e tatimit të tregtisë ndërkombëtare. Tatimet e tregtisë ndërkombëtare kanë zënë 5 deri në 6 përqind të të gjitha të ardhurave në vitin 2006, por përqindja e tyre kishte rënë deri në 2 përqind në vitin 2012 (Figura 23). Vetëm në Kosovë, e cila nuk e ka nënshkruar ende MSA-në, tatimet tregtare janë ende të larta. Në të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar MSA-të, të ardhurat nga tatimet tregtare filluan të ulen për shkak të përgatitjeve për marrëveshjen.

Rritjet e taksave të akcizës dhe e granteve të jashtme kanë ndihmuar në minimizimin e mungesave në të ardhura. Të ardhurat nga akciza u rritën me mesatarisht 0.2 përqind e PBB-së në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2012. Megjithatë, me produkte të tilla si cigaret të cilat kanë ende kanë çmime më të ulëta në të gjithë rajonit se në Evropën Perëndimore, mund të ketë më shumë hapësirë që të rriten këto të ardhura ndërsa përmirësohen rezultatet e tjera të politikave publike (p.sh. politikat e shëndetit nëpërmjet uljes së duhanpirjes). Rritja e granteve me 0.2 përqind e PBB-së, duke përfshirë dhe Instrumentin e Parapranimit të BE-së (IPA) kanë ndihmuar po ashtu në mbushjen e boshllëkut.

vI | **Figura 20: Ndryshimi në të ardhura, 2009-13, (% GDP)**

Figura 21: Kontributi mesatar drejt ndryshimit në të ardhurat, (% PBB, burimet e përzgjedhura të të ardhurave: 2009-12)


¹⁰ Të gjitha shifrat mesatare të prezantuara në këtë seksion fiskal të këtij raporti janë të paponderuara.




Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore; *PIT dhe CIT nuk përfshijnë Bosnjë dhe Hercegovinë, ku është e vështirë të ndahen këto dy lloje tatimesh mbi të ardhurat.

Figura 22: Tatimi mbi tregtisë ndërkombëtare, % e PBB-së

Figura 23: Tatime mbi tregtisë si % e të ardhurave të përgjithshme



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.




Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Shtetet e EJT-së përballen me sfida të rëndësishme fiskale për shkak të shtrëngesave strukturore në shpenzimet publike. Fatura e pagave të sektorit publik, e cila reflekton pjesërisht përmasën e konsiderueshme të sektorit publik, është rritur nga mesatarja prej 8.9 përqind e PBB-së në vitin 2008 deri në 9.7 përqind të PBB-së në vitin 2012. Kjo faturë e ka tejkaluar nivelin prej 11 përqind të PBB-së në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi, duke marrë rreth 26.2 përqind të shpenzimeve të përgjithshme. Kosova, e cila më parë ka pasur një faturë pagash të përmbajtur, ka rritur po ashtu me shpejtësi faturën e saj të pagave, nga 5.9 përqind e PBB-së në vitin 2008 në 8.4 përqind në vitin 2012, dhe shoqëruar me rritje të mëtejshme kohët e fundit në pagat e sektorit publik. Vetëm Shqipëria dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë ia kanë dalë në kufizimin e pagave të sektorit publik, me rënie për këtë zë nga 6.1 përqind e PBB-së në 5.1 përqind të PBB-së në periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2012 në Shqipëri, dhe nga 8.1 deri në 7.5 përqind të PBB-së në periudhën nga viti 2009 deri në vitin 2012 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, pagat e sektorit publik parashikohen të rriten në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë në tetor të vitit 2014 pas ngrirjes së tyre që prej vitit 2009.

Siç është vënë re dhe në edicionin e mëparshëm të këtij *Raporti të Rregullt Ekonomik*, shpenzimet për pensionet dhe përfitimet sociale mbeten ende të larta dhe shpesh nuk shkojnë tek personat më në nevojë. Rritjet e kohëve të fundit të përfitimeve për veteranët e luftës (të cilët nuk targetohen si grup i varfët) në Kosovë përbëjnë lëvizje në drejtimin e gabuar. Pensionet në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë janë rritur me 5 përqind në mars të vitit 2013 dhe më pas sërish me 5 përqind në mars të vitit 2014, ndërkohë që në programin e saj zgjedhor qeveria deklaroi se do të vijojë të rrisë pensionet dhe përfitimet sociale çdo vit. Në Shqipëri, rritja e pensioneve e kohëve të fundit preku 60 përqind të majës së popullsisë, duke mos arritur kështu të prekë personat më në nevojë.

Figura 24: Shpenzimi kapital, % e PBB-së




Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe stafit të Bankës Botërore.

Shpenzimet kapitale vijuan të binin në vitin 2013. Shpenzimet kapitale ranë më poshtë se 4 përqind e PBB-së në fund të vitit 2013 në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Mal të Zi dhe Serbi. Pavarësisht nga nevojat e dukshme infrastrukturore, të gjitha shtetet e EJL-së (përveç Kosovës) i kanë shkurtuar shpenzimet kapitale si përqindje e PBB-së ndërmjet periudhës nga viti 2008 deri në vitin 2013, ndërkohë që kanë rritur faturat e pagave dhe transfertat sociale (Figura 24). Edhe në Kosovë, rritja e shpenzimeve kapitale ka qenë kryesisht jo eficente, e përqendruar në një projekt të madh infrastrukture rrugore, niveli i kthimit ekonomik i të cilit mund të mos jetë i lartë.

Planet e buxhetit të vitit 2014 sugjerojnë përpjekje të vazhdueshme për të konsoliduar pozicionet financiare nga qeveritë e EJL6-ës. Deficitet financiarë të shteteve të EJL6-ës parashikohen të rriten me mesatarisht 0.3 përqind të PBB-së në vitin 2014. Por, ndërmjet shteteve të EJL6-ës vihen re dy grupe shtetesh. Sipas buxheteve të tyre përkatëse, deficitet parashikohen të ulen në Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Jugosllavisë ndërsa rriten të ardhurat dhe ngushtohen shpenzimet (Figura 25). Megjithatë, plotësimi i këtyre objektivave mund të jetë sfiduese. Në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë autoritetet arritën nivelin e 61 përqind të deficitit buxhetor për vitin 2014 në tremujorin e parë të vitit, ndërkohë që një rezultat i ngjashëm në tremujorin e parë të vitit 2013 çoi në rritje të deficitit. Në Kosovë, autoritetet janë angazhuar të ruajnë nivelin e deficitit në përputhje me rregullin fiskal prej 2 përqind të PBB-së (nga 3 përqind në vitin 2013), por rritjet e konsiderueshme në pagat e shërbimit publik dhe përfitimet për veteranët e luftës nënkuptojnë që respektimi i këtij objektivi mund të rezultojë i vështirë. Në Malin e Zi parashikohet konsolidim i mëtejshëm në përputhje me rregullimin fiskal që etiketon përkatësisht 3 dhe 60 përqind të PBB-së dhe të tavanit të borxhit. Gjithsesi, arritja e objektivave fiskale mund të rezultojë e vështirë duke pasur parasysh projektet e planifikuara infrastrukturore. Grupi tjetër i shteteve përfshin Shqipërinë dhe Serbinë. Të ardhurat parashikohen të rriten në Shqipëri dhe në Serbi në fund të vitit të ndryshimeve të politikave tatimore dhe përpjekjeve për të përmirësuar mbledhjet e faturave tatimore. Por, deficitin fiskal i Shqipërisë në vitin 2014 parashikohet të rritet për shkak të përpjekjes së madhe për pagimin e pagesave të prapambetura (2.5 përqind e PBB-së). Deficitin e parashikuar i Serbisë për vitin 2014 është më i lartë se viti 2013 për shkak të masave të lidhura me rikapitalizimin e bankës dhe pagesës së buxhetuar për reformën e sektorit të SOE. Nëse do të përjashtoheshin këto masa shpenzimesh, deficit fiskal në vitin 2014 do të ishte më i ulët. Aktualisht po shqyrtohen masa të

mëtejshme për konsolidimin e shpenzimeve duke prekur disa shtrëngime strukturore (p.sh. pagat publike, pensionet) si në Malin e Zi dhe në Serbi, gjë e cila do të ngushtonte deficitin e planifikuar.

Figura 25: Kontributi në drejtim të ndryshimit të deficitit, 2013-14, % e PBB-së



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.


Duke reflektuar rimëkëmbje të vogël të rritjes dhe konsolidim të vonuar fiskal, borxhi publik vijoi të rritet në vitin 2013 dhe parashikohet të rritet më tej në vitin 2014. Borxhi publik mesatar duke përjashtuar garancitë u rrit nga 41.9 përqind të PBB-së në vitin 2012 në 44.7 përqind në vitin 2013 ndërsa shteteve të EJT-së iu desh të merrnin hua për të financuar deficitet fiskale (Figura 26). Borxhi publik parashikohet të rritet më tej në vitin 2014 në përputhje me rritjen e deficiteve fiskale. Borxhi publik, duke përjashtuar garancitë, është mbi 60 përqind e PBB-së në Shqipëri dhe po i afrohet këtij niveli dhe në Malin e Zi dhe në Serbi¹¹. Një autostradë e shtrenjtë në Malin e Zi, e vlerësuar të kushtojë rreth 25 përqind të PBB-së, planifikohet të financohet nëpërmjet një huamarrje të re. Kërkimet e kohëve të fundit sugjerojnë se borxhi i rritur shpejt ka po aq të ngjarë të ngadalësojë rritjen ekonomike sa edhe borxhi i lartë (shih Pescatori et al., 2012¹²).

Garancitë qeveritare vijuan të shtonin rrezikun fiskal mbi situatën fiskale të tendosor që në vitin 2013. Garancitë përlogariten të kenë shtuar mesatarisht 5.4 përqind të PBB-së në borxhin e sektorit publik. Ndërkohë që ky nivel është pak më i ulët se niveli prej 5.8 përqind i vlerësuar për vitin 2012, qeveritë duhet t'i kushtojnë kujdes garantimit të sektorit privat, ose borxhit të SOE-së. Këto pengesa i shtohen garancive të shprehura, të tilla si pensionet, të cilat po rriten shpejt në ekonominë në praktikë.

Figura 26: Borxhi publik dhe garancitë, (% e PBB-së)

¹¹ FMN-ja propozon pragje borxhi prej 60 përqind të PBB-së për ekonominë e avancuar dhe 40 përqind për tregjet në zhvillim për të menaxhuar rrezikun e krizave të borxhit. Shih për shembull Baldacci et al. (2013). Mund ta gjeni në adresën: <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2013/wp13238.pdf>

¹² <http://www.imf.org/external/pubs/ft/wp/2014/wp1434.pdf>



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Vlerësimet e kreditimit të shteteve të EJM6-ës kanë mbetur goxha të qëndrueshme në vitin 2013. Me performancë mikse fiskale, rajoni ka kaluar vetëm dy ulje. Standard and Poor e uli nivelin e kreditimit të Shqipërisë në dhjetor të 2013-ës, kryesisht për shkak të rritjes së borxhit publik (Tabela 2), megjithëse kjo situatë është shkaktuar pjesërisht për shkak të njohjes së pagesave të mëdha të prapambetura, ndërkohë që përpjekjet për t'i marrë ato në konsideratë dhe për t'i shlyer janë mirëpritur. Vlerësimi i Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ra në maj të vitit 2013.

Tabela 2: Vlerësimet e Borxhit Sovran

	Dec 2010	Dec 2011	Dec 2012	Dec 2013	Feb 2014
ALB	B+	B+	B+	B	B
BiH	B+	B	B	B	B
MKD	BB	BB	BB	BB-	BB-
MNE	BB	BB	BB-	BB-	BB-
SRB	BB-	BB	BB-	BB-	BB-

Burimi: Standard and Poor.

Mbajtja e borxhit publik në nivele të qëndrueshme dhe sigurimi i shpenzimeve publike ndihmon në inkurajimin e rritjes dhe kërkon “konsolidim të zgjuar fiskal”. Është e mundur që të realizohet një konsolidim fiskal që eliminon teprinë dhe kontrollon faturën e pagave të sektorit publik, ndërkohë që ruan shpenzimet produktive në ngërçet infrastrukturore, duke ua drejtuar shpenzimet të varfërve dhe duke realizuar shpenzimet e nevojshme për programe riaktivizimi të tregut të punës për grupet e synuara. Tjetërsimi i tendencave të politikave aktuale për të shkurtuar shpenzimet kapitale dhe për të rritur pagat e sektorit publik mund të ndihmojë në mbështetjen e rritjes ekonomike.

Konsolidimi i zgjuar fiskal për qëndrueshmërinë fiskale në kuadrin afatmesëm deri në kuadrin afatgjatë kërkon masa në disa fronte. Së pari, dhe kryesisht kërkohej përpjekje të vazhdueshme për konsolidim fiskal për t'u siguruar se ekziston një hapësirë politikash për të përballuar vështirësitë dhe për të ulur nivelet e borxhit publik. Por, burimet e shkurtimeve të shpenzimeve kanë rendësi. Shumë nga shtetet e EJM-së kanë hapësira për të ulur shpenzimet publike, veçanërisht në faturën e pagave publike dhe në përfitimet e targetuara jo siç duhet për mbrojtjen sociale. Së dyti, reformat strukturore në ekonomi në nivel më të përgjithshëm (për shembull, përmirësimet në klimën e biznesit) mund të ndihmojnë në nxitjen e sektorit privat me përfitime dytësore për të ardhurat e sektorit publik. Së treti, investimet për


nxitjen e rritjes nëpërmjet përdorimit më të madh të fondeve të Instrumentit për Ndhmën Parapranimit (IPA) do të krijonin hapësirat shumë të dëshiruara fiskale.

Inflacioni në ulje dhe shumë i ulët

Inflacion ka rënë në mënyrë të ndjeshme në të gjithë rajonin e EJL6-ës gjatë vitit 2013. Me zhdukjen e efekteve të rritjeve në ushqime dhe të çmimeve të administruara si dhe të taksave, rajoni ka përjetuar një rënie dramatike të nivelit të inflacionit, i cili madje në disa shtete është kthyer në deflacion (Figura 27). Të katërt shtetet të cilat i kanë të stabilizuara monedhat e tyre me euron (nëpërmjet bordeve të monedhave, stabilizimit të rëndë, ose eurozimi të njëanshëm) kanë shënuar inflacion më të ulët sesa Serbia dhe Shqipëria me fleksibilitet të plotë të politikave monetare. Në fund të vitit 2013 ka pasur deflacion në Bosnjë dhe Hercegovinë (ku CPI-ja ra me 1.2 përqind), ndërsa në Serbi inflacioni ka qenë i ulët në mënyrë të pazakontë (2.2 përqind). Diferenca ndërmjet inflacionit në shtetet e EJL6-ës dhe në shtetet e BE11-ës dhe BE15-ës u ul nga rreth 5 pikë përqindje në fund të vitit 2012 në vetëm një gjysëm pike përqindje në shkurt të vitit 2014 (Figura 28).

Presionet në rënie të çmimeve vijuan në pjesën më të madhe të shteteve në fillim të vitit 2014. Pavarësisht nga presionet deflacioniste në Bosnjë dhe Hercegovinë, paralelisht me ngadalësimin e mëtejshëm të inflacionit në Kosovë dhe në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, rritjet vjetore në çmimet e konsumit në Serbi dhe në Shqipëri e mbajtën inflacionin në ELG6 në dy muajt e pare të 2014-ës të pandryshuar krahasuar me dhjetorin e vitit 2013 (me 1.2 përqind).


Figura 27: Inflacioni i CPI-së, përqindja (y-o-y)



Shënim: EJL6 mesatarja e ponderuar.

Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Figura 28: Krahësim Rajonal Inflacioni i CPI-së, përqindje (y-o-y)




Shënim: Inflacionet rajonale janë me mesatare të ponderuar.

Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Rënia botërore e çmimeve të ushqimeve ishte një ndër shkaktarët kryesorë të rënies së inflacionit të CPI-së në shtetet e EJL6-ës në vitin 2013 dhe në fillim të vitit fiskal 2014 (Figura 29). Në fund të vitit 2013, Serbia ka shënuar rënien më të madhe ndërmjet shteteve të EJL6-ës për çmimet e konsumit krahasuar me dhjetorin e 2012-ës (me 10 pikë përqindje) për shkak të rënies në çmimet e ushqimeve. Përjashtim ishte Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, ku zhvillimet e inflacionit u nxitën nga një ngadalësim në çmimet globale të energjisë dhe nga efekti tkurrës i rritjeve të brendshme më parë në vitin 2012 (Figura 30).


Figura 29: Inflacioni në çmimet e ushqimeve, në përqindja (y-o-y)



Note: EJL6-a me mesatare të ponderuar.

Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.


Figura 30: Inflacioni i çmimit të energjisë, në përqindje (y-o-y)



Sbënim: EJL6-a me mesatare të ponderuar.

Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Figure 31: Hendeku i prodhimit në EJL6 (% e PBB-së potenciale)



Note: Nuk ka vlerësime për Kosovën.

Burimi: IMF WEO dhe raportet e stafit të shteteve të EJL-së.

nivelin përpara krizës kryesisht për të lehtësuar financimin: në 9.5 përqind dhe 8.5 përqind (në varësit të maturimit të instrumentit) në Mal të Zi, 10 përqind dhe 7 përqind në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe në 10 përqind në Kosovë. Si rezultat, agregati monetar M2 është rritur lehtë në shtetet e EJL6-ës gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, kur rezerva reale e mjeteve monetare në dhjetor të vitit 2013 ishte rreth 6 përqind më e lartë se në mars të vitit 2009 (Figura 33). Gjithsesi, ekspansioni monetar në shtetet e BE15-së në 24 përqind (krahasuar me marsin e vitit 2009) ishte goxha më i lartë sesa në shtetet e EJL6-ës ose të BE11-ës.


Në këtë mjedis me inflacion të ulët, bankat qendrore të EJL6-ës janë angazhuar në lëshim të moderuar të politikave monetare.

Kërkesa e ngathët e brendshme në vitin 2013 la shumë kapacitet prodhimi të pasfrytëzuar në këto ekonomi, duke kontribuar në një hendek negativ prodhimi (Figure 31). Për të mbështetur likuiditetin dhe për të rritur aksesin në financim, bankat qendrore të Shqipërisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë¹³ dhe Serbisë i shkurtuan nivelet e tyre bazë të interesit në vitin 2013 me përkatësisht 1, 0.5 dhe 1.75 pikë përqindje (Figura 32). Duke pasur parasysh objektin e kufizuar të politikës së tyre monetare, Bosnjë dhe Hercegovina, Kosova dhe Mali i Zi¹⁴ i ulën kërkesat për rezervat e bankës në

¹³ Banka Kombëtare e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë ka përdorur masa jostandarde monitorimi për të bërë të mundur mbështetjen e kreditimit për sektorin e biznesit si dhe për të siguruar futjen e kapitalit të huaj afatgjatë në ekonominë e brendshme.


¹⁴ Kosova dhe Mali i Zi përdorin në mënyrë unilaterale euron si monedhën e tyre të vetme ligjore, ndërsa Bosnja dhe Hercegovina ka një bord monedhe të bazuar tek euroja.

Figura 32: Nivelet e politikave zyrtare (%)



Burimi: ECB, Zyrtat kombëtare të statistikave.

Figura 33: Furnizimi real i gjerë me instrumente monetare,
Indeksi (2009:Q1=100)



Burimi: FMN-ja, IFS-ja, ECB-ja, Eurostat-i, bankat qendrore kombëtare.

Lehtësimi i mëtejshëm duhet të realizohet me kujdes në shtetet e EJL6-ës. Duke pasur parasysh presionet deflacioniste, hendeqet ende të mëdha të prodhimit, dhe faktin se furnizimi me instrumente financiare ka filluar vetëm kohët e fundit të rritet më shpejt se të ardhurat nominale, duket se ka mundësi për lehtësim të mëtejshëm në shtetet me fleksibilitet monetar. Megjithatë, nëse zgjidhet kjo rrugë, lehtësimi monetar duhet të jetë gradual. Për më tepër, presioni mbi kurset e këmbimit në shtetet me nivele fleksibël këmbimi mund të kufizojë hapësirën për lehtësim politikash. Në të katër shtetet me monedha të stabilizuara me euron ka instrumente të kufizuara të politikave monetare për të kapërcyer presionet deflacioniste. Kjo mund të ketë ndikim mbi borxhin e tyre publik nëpërmjet PBB-së më të ulët nominale dhe të ardhurave potencialisht më të ulëta. Për më tepër, në një mjedis deflacionar, familjet dhe firmat mund të shohin rritjen e borxhit të tyre në raport me të ardhurat, situatë e cila mund të çojë përkeqësimin e huave të këqija.

Sektor financiar i qëndrueshëm, megjithëse i brishtë

Megjithëse i brishtë, sektori financiar i shteteve të EJL6-ës ka qenë përgjithësisht i qëndrueshëm në vitin 2013 dhe në fillim të vitit 2014. Performanca e tij bazuar në një sërë treguesish financiarë nuk sugjeron përkeqësim të situatës:

- **Kushtet e financimit për shtetet e EJL6-ës u përmirësuan gjatë gjysmës së dytë të vitit 2013, ndërkohë që mosdibursimi i bankave të huaja vijon ende** (Figura 34). Duke marrë parasysh rritjen e paqëndrueshmërisë në treg dhe kushtet e shtrënguara globale të likuiditetit gjatë tremujorit të 3-të të vitit 2013, financimi i huaj në shtetet e EJL6-ës vijoi të ulej (ku tremujori i 4-rt i 2013-ës ndoqi thajse të njëjtën rrugë). Shpërndarjet e Opsionit të Shkëmbimit të Kredive të Këqija (CDS) arritën në nivelet e tyre më të ulëta që prej krizës për pjesën më të madhe të borxhit

sovrani në shtetet e EJT6-së dhe për bankat që funksionojnë në rajon, duke reflektuar kështu vijimin e konsolidimit të bilanceve të bankave evropiane, i cili ka të ngjarë të vijojë në situatën e testeve të stresit të sektorit bankar në Eurozonë (Figura 35).¹⁵ Gjithsesi, rreziku i mosdisbursimit është ende i pranishëm për shkak se disa prej bankave mëmë greke, sllovene ose austriake kanë ngadalësuar ritmin përballë presioneve të vazhdueshme të tregut dhe atyre rregullatore. Kontrollat e cilësisë së aktiveve nga Banka Qendrore Evropiane (ECB) dhe testet e stresit i kanë shtuar elementët e pasigurisë.

- **Fitimi i bankave në vitin 2013 është ulur në pjesën më të madhe të shteteve dhe është ende larg niveleve para krizës** (Figura 36). Katër nga gjashtë shtetet kanë përjetuar një ulje të fitimit të bankave të tyre, me Bosnjë dhe Hercegovinën që ka shënuar rënien më të madhe. Fitimet e bankave u rritën vetëm në Malin e Zi, pas rezultatit negativ në vitin 2012, ndërsa Kosova ka pasur nivelin më të lartë të fitimit të bankave në të gjithë rajonin.
- **Raportet e huave me depozitat janë përmirësuar në vitin 2013, por kanë vijuar të jenë të larta në tre prej gjashtë shteteve në rajon** (Figura 37). Serbia ka ulur më tej raportin e huave me depozitat, ndërkohë që bankat e saj e kanë rritur ndjeshëm likuiditetin gjatë dy viteve të fundit, por Serbia ka nivelin më të lartë në rajon për këtë zë, me 131 përqind në fund të vitit 2013. Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi janë dy shtetet e tjera me raporte hua / kredi më të larta me 100, duke variuar diku në raportin 114 në fund të vitit 2013.
- **Bankat rajonale kanë ruajtur likuiditetin e tyre dhe kanë kapitale në nivele të mira.** Në përgjithësi likuiditeti në sistemin bankar në rajon është në nivel të kënaqshëm, pavarësisht uljes së likuiditetit në shumë shtete të tjera (Figura 38). Gjithsesi, bankat individuale në disa shtete mund të hasen me disa vështirësi. Mesatarisht, raportet e mjaftueshmërisë së kapitalit bankar në të gjithë rajonin janë të pozicionit të fortë (Figura 39). Pavarësisht nga kjo, secili shtet ka disa banka të cilat po luftojnë për të plotësuar kërkesat për kapital.

Figura 34: Financimi dhe Kostot e Financimit për EJT6-ën





Figura 35: Shpërndarjet e CDS-së për EJT6-ën



vI | *Balkan Insight* Bloomberg, Banka e Rregullimeve Ndërkombëtare (BIS) dhe stafi i Bankës Botërore.
Shënim: *Shumat janë të rrumbullakosura bazuar në kursin e këmbimit dhe shtetet e EJT6-së përfshijnë: Shqipërinë, Bosnjë dhe


¹⁵ Bazuar në të dhënat e fundit të ECB-së, rënia e prerë e bilancit agregat të bankave në Eurozonë në dhjetor të vitit 2013 (Figura 14) u shkaktua pjesërisht nga ulja e aktiveve të tyre të jashtme, e cila me sa duket përfshiu uljen e financimit të tregjeve në zhvillim prej tyre.

Hercegovinën, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë.

** Bankat përfshijnë: Bankën Raiffeisen, Bankën Erste, Bankën Intesa, Bankën UniCredit, Societe Generale, Bankën Kombëtare të Greqisë (NBG) dhe Bankën Alpha.


*** Shtetet përfshijnë: Shqipërinë, Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Malin e Zi dhe Serbinë

Figura 36: Kthimi mesatar i aktiveve (ROA)



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.


Figura 37: Raportet e huave me depozitat



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Shënim: Për shkak të harmonizimit të kontabilitetit me SNRF-të të dhënat për Malin e Zi nuk janë të krahasueshme.


Figura 38: Raporti i Likuiditetit



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Shënim: Të dhënat për Serbinë për Raportin Mesatar Tremujor të Mjaftueshmërisë së Kapitalit për periudhën 2006-2008 i referohen vetëm 2008-ës.

Figura 39: Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit




Përkundrejt kësaj situate, dy janë sfidat kryesore të cilat kanë nevojë për masa të menjëhershme nga organet përgjegjëse: rinisja e rritjes së kreditimit në mënyrë të qëndrueshme, në veçanti e huamarrjes së bizneseve, dhe tjetërsimi i kurbës në rritje të huave të këqija (NPL).

Së pari, në të gjithë rajonin, pavarësisht shenjave të rritjes, kreditimi i biznesit u ul në vitin 2013, duke çuar në një rimëkëmbje kryesisht pa kreditim. Rritja e shpejtë e huave të këqija (Figura 40), prezantimi i standardeve më strikte për përgjegjësitë e kreditimit, përpjekjet e bankave për të pastruar bilancet e tyre dhe për të mbuluar kostot e tyre e kanë shtuar presionin mbi huamarrjen dhe e kanë ngadalësuar deri në zvarritje rritjen e kreditimit në të gjitha shtetet e EJJL6-ës në vitin 2013 (Figura 41). Rritja e kreditimit është ngadalësuar në Shqipëri, në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe në Kosovë, ku Kosova ka regjistruar uljen më të madhe nga të tria shtetet. Në Serbi, rritja e kreditimit u bë negative në vitin 2013 si rezultat i kontraktimit të huadhënies për bizneset. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi ishin të vetmet shtete ku u përshpejtua rritja e kreditimit në vitin 2013. Në Malin e Zi kjo situatë është shkaktuar për shkak të transferimit të huave të këqija nga bilancet e padeklaruara të bankave.

Së dyti, huatë e këqija arritën nivelet e tyre më të larta historike në fund të vitit 2013. Huatë e këqija u rritën me më shumë se tre herë nga mesatarja prej 5 përqind në periudhën para krizës në deri 16 përqind në fund të 2013-ës. Shqipëria dhe Serbia kanë shënuar nivelin më të lartë të huave të këqija në fund të vitit 2013, ose duke arritur kulmin e tyre historik, ose duke iu afruar shumë këtij kulmi. Po ashtu, Mali i Zi ka shënuar një nivel të lartë të huave të këqija, por ndryshe nga Shqipëria dhe nga Serbia, ai ka shënuar një ulje nga niveli prej 25 përqind në fillim të vitit 2011 në 18 përqind në vitin 2013.¹⁶ Bosnja dhe Hercegovina kanë shënuar po ashtu një rritje të huave të këqija në nivelin historik prej 15 përqind (pavarësisht “shitjes së shumicës” së huave të këqija në vitin 2011 dhe 2012), ndëkohë që huatë e këqija në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë arritën nivelin më të lartë prej 12 përqind në tremujorin e dytë të 2013-ës, para se të uleshin lehtë në gjysmën e dytë të vitit. Huatë e këqija në Kosovë kanë qenë po ashtu në nivelet më të larta, megjithëse goxha më poshtë mesatares së rajonit. Nëse nuk ulen, huatë e këqija do të vijojnë të ngarkojnë bilancet e bankave, të çojnë në kosto të larta mbledhje dhe të ngadalësojnë procesin e rimëkëmbjes pasi bankat kanë më pak kapacitet huadhënës dhe bëhen më kundërshtuese ndaj rrezikut (për trajtim më të plotë të huave të këqija, shihni Momentin e Rëndësishëm 2).


Figura 40: Huatë e këqija (% e totalit të huave)



Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Shënim: Të dhënat nga niveli i huave të këqija para krizës (2006-2008) për Serbinë i referohen vetëm fundit të vitit 2008

Figura 41: Nivelet e rritjes së kreditimit (% ndryshimi)



Shënim: Niveli mesatar i rritjes për periudhën 2003-2005 për Shqipërinë dhe Serbinë dhe për periudhën 2004-2005 për Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe Malin e Zi.

Burimi: Llogaritje të autoriteteve kombëtare dhe të stafit të Bankës Botërore.

Ka ardhur koha që autoritetet të merren një herë e mirë me sfidën e rritjes së huave të këqija (shih Momentin e Rëndësishëm 2). Megjithëse nivelet e larta të huave të këqija nuk kanë shkaktuar mungesë të theksuar stabiliteti të sektorit financiar pasi këto hua janë të provigjonuara dhe të mbështetur nga kapitali i nevojshëm bankar, mostrajtimi i këtij rreziku nga koka mund të destabilizojë më tej sektorin e brishtë bankar dhe mund të kërcënojë procesin e rimëkëmbjes.

¹⁶ Rënia erdhi kryesisht si rezultat i “shitjes së pjesës më të madhe” të huave të këqija në vitin 2011 dhe 2012.

II. Perspektivat

Perspektivat afatshkurtra të rritjes dhe parashikimet aftamesme

Tabela 3: Rritja reale dhe parashikimet e e PBB-së

	2012	2013 ^e	2014 ^f	2015 ^f
Albania	1.3	0.4	2.1	3.3
Bosnia and Herzegovina	-1.1	0.8	2.0	3.5
Kosovo	2.7	3.0	3.5	3.5
FYR Macedonia	-0.4	3.1	3.0	3.5
Montenegro	-2.5	3.5	3.2	3.5
Serbia	-1.7	2.5	1.0	1.5
SEE6	-0.7	2.1	1.9	2.6
<i>Memo item:</i>				
Euro Area	-0.7	-0.4	1.2	1.7
EU11	0.8	1.4	2.4	2.7

Burime: Parashikimet e stafit të Bankës Botërore.

Shënim: mesatarja e ponderuar

parashikohet të jetë nën nivelin e rritjes së BE11-ës (1.9 kundrejt 2.4 përqind).

Rajoni i EJL-së parashikohet të rritet me 1.9 përqind në vitin 2014. Parashikimi për rritjen në shtetet e EJL6-ës është pak më i lartë se kaq (me 0.1 pikë përqindje) dhe përgjithësisht në përputhje me parashikimin e Raportit të Rregullt Ekonomik për ELL6-ën të dhjetorit 2013. Rritja pritët të mbetet pozitive në vitin 2014 në të gjitha shtetet e EJL6-ës. Ajo ka gjasa të konsolidohet në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në Malin e Zi, të përshpejtohet në vitin 2014 në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë dhe Kosovë dhe të ngadalësohet në Serbi. Serbia mbetet shteti me ekonominë me rritje më të ngadaltë, ndërsa Kosova shteti me ekonominë me rritje më të shpejtë (Tabela 3). Rritja ekonomike e EJL6-ës në vitin 2014

Perspektiva e rritjes ekonomike e shteteve të EJL6-ës në vitin 2014 përcaktohet nga rimëkëmbja e qëndrueshme e kërkesës së jashtme. Rritja pozitive që prej mesit të 2013-ës dhe kushtet ende akomoduese monetare të Eurozonës kanë të ngjatë të vijojnë të ndihmojnë shtetet e EJL6-ës të rrisin eksportet e tyre. Megjithatë, aktiviteti ekonomik i EJL6-ës është zvogëluar nga kërkesa e brendshme e dobët. Serbia, ekonomia më e madhe e EJL6-ës, duket se po shkon drejt një konsolidimi të konsiderueshëm fiskal për ta çuar borxhin e saj të brendshëm në një nivel të qëndrueshëm, gjë mund të ngadalësojë aktivitetin e saj ekonomik. Nga ana tjetër, rritja ekonomike në pesë shtetet e tjera të EJL6-ës pritët të konsolidohet në vitin 2014 dhe të tejkalojë ritmin e ekspansionit ekonomik të 2013-ës, në përputhje me një kërkesë të pritshme të brendshme më të fortë, ulje modeste të papunësisë dhe përmirësim të kushteve të kreditimit. Rritja e Shqipërisë parashikohet në 2.1 përqind, pasi likuidimi i pagesave të prapambetura nga qeveria pritët të injektojë likuiditetin që është aq shumë i nevojshëm për sektorin privat dhe për të mbështetur rritjen. Ekonomitë e Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Kosovës, dhe Malit të Zi kanë zhvillime në ndërtim, shërbime dhe turizëm, por përqindja e tyre në ekonomitë rajonale të EJL6-ës është shumë modeste për të ndryshuar situatën e përgjithshme të rajonit.

Politikat ekonomike mund të jenë shumë të rëndësishme për rritjen ekonomike në kuadrin afatshkurtër dhe afatmesëm në EJL6. Në aspektin fiskal, përpjekja e qëndrueshme për reformë është e nevojshme për të trajtuar kufizimet strukturore në buxhetet e EJL6-ës. Përparësitë përfshijnë: ndryshimet në kompozimin e shpenzimeve publike drejt investimeve dhe larg pagave, targetimin e shpenzimeve publike, përcaktimin e përparësive dhe përmirësimet në mbledhjen e të ardhurave dhe në zgjerimin e bazës së tatueshme (ndërmjet të tjerash). Për sa i përket aspektit të politikave monetare, me inflacionin rajonal në nivelin shumë të ulët prej 1.2 përqind dhe me hendeqe të mëdha ende ekzistuese në prodhim, ekzistojnë mundësi për lehtësim afatshkurtër të kushteve monetare, veçanërisht në ato shtete ku deficitet kanë filluar të ulen. Gjithsesi, në ekonomitë me nivele fleksibël të kursit valuator duhet të kushtohet


kujdes për t'u siguruar se ato nuk bien nën presion. Për sa i përket politikave të sektorit financiar, një trajtim i nivelit të lartë për huatë e këqija është shumë i rëndësishëm për rikthimin e rritjes së kreditimit, mbështetjen e sipërmarrjeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës.

Rritja në shtetet e EJL6-ës pritet të përshpejtohet mesatarisht me 2.6 përqind. Të gjashtë ekonomitë e EJL-së në diskutim pritet të kontribuojnë në përshpejtimin e ritmeve të rritjes ndërkohë që konsolidohet kërkesa e jashtme dhe fillon të rimëkëmbet kërkesa e brendshme. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova dhe Serbia të gjitha parashikohen të kenë rritje më të madhe ose të njëjtë në vitin 2015 krahasuar me vitin 2014. Në vitin 2015, ekonomitë e EJL6-ës parashikohen të rriten pak më ngadalë sesa mesatarja e rritjes në shtetet e BE11-ës (2.6 përqind krahasuar me 2.7 përqind rritje për BE11-en).

Ka rreziqe domethënëse negative lidhur me parashikimin makroekonomik për rajonin e EJL6-ë. Këto rreziqe, si të jashtme (shih Kutinë 3) dhe të brendshme, lidhen me:

- (i) Rreziqet deflacioniste në Eurozonë, të cilat çojnë në rimëkëmbje të dobët ekonomike në eurozonë: ritmi i rimëkëmbjes së Eurozonës mund të jetë më u dobët për shkak të disinflacionit, ose madje dhe të deflacionit. Kjo situatë do të çonte në uljen e rritjes së eksportit, i cili ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm për rimëkëmbjen foshnjore ekonomike të shteteve të EJL6-ës.
- (ii) Ritmi në rritje i niveleve globale të interesit: në kuadrin e uljes graduale të Rezervës Federale të Shteteve të Bashkuara, ekonomitë e tregjeve në zhvillim dhe ekonomitë e reja, duke përfshirë dhe EJL-en, po futen në një periudhë shtrëngesash të pritshme financiare globale në kuadrin afatmesëm. Kjo mund të ketë ndikime për prurjet financiare në rajon. Rreziqet globale janë diskutuar në Kutinë 3.

Figura 42: Niveli i rritjes reale të PBB-së në EJL6 sipas skenarit bazë dhe skenarit të ulët



(iii) Pasojat potenciale gjeopolitike të konfliktit ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës: përshkallëzimi i krizës potenciale mund të paraqesë rreziqe të reja për Evropën. Ndërsa lidhjet e EJL6-ës me Rusinë dhe Ukrainën janë të kufizuara, tensionet e mëtejshme gjeopolitike mund të kenë pasoja të pashmangshme të drejtpërdrejta (nëpërmjet kanaleve tregtare dhe financiare) dhe të tërthorta (nëpërmjet efekteve të nivelit të

dytë që vijnë nëpërmjet Evropës) për rritjen ekonomike për rajonin e EJT6-ës. Rrezeq më të gjera lidhen me prekjën dhe me ndikimin negativ mbi besimin e investitorëve si rezultat i konfliktit ndërmjet Rusisë dhe Ukrainës.

- (iv) Përpjekjet e pamjaftueshme për të trajtuar pjesën e mbetur të dobësive strukturore: "lodhja nga reformat" mund të vonojë zbatimin e politikave të projektuara për të përmirësuar, për shembull, klimën e biznesit, ose për të trajtuar dobësitë e tregjeve të punës, ose për të ulur deficitin e madh fiskal strukturor, ose për të ristrukturuar sektorin e ndërmarrjeve të zotëruara nga shteti. Për më tepër, sfidat fiskale për të stabilizuar dhe për të ulur borxhin publik në disa shtete mund të duken të frikshme. Po ashtu, mungesa e progresit lidhur me zgjidhjen për huatë e këqija, pagesat e prapambetura të sektorit privat për furnizuesit mund të ndikojnë negativisht rimëkëmbjen e kreditimit dhe mundësitë e rritjes.
- (v) Tensionet social-politike: Pavarësisht niveleve të ndryshme të shteteve të EJL6-ës, nivelet e larta të papunësisë, përpjekjet ristrukturuese të SOE-s dhe zgjedhjet në Bosnjë Hercegovinë dhe Kosovë janë ndërmjet faktorëve që mund të çojnë në rritje të tensioneve sociale, siç është vënë re kohët e fundit në Bosnjë dhe Hercegovinë.

Këto rreziqe të jashtme dhe të brendshme, nëse materializohen, do të kenë ndikime negative mbi perspektivat e rritjes në shtetet e EJL6-ës dhe do të ngadalësojnë rritjen ekonomike foshnjore të tyre (Figura 42). Në rastin ekstrem të përkeqësimit të madh të kushteve ekonomike për shkak të ngjarjeve të rreziqeve të përmendura më sipër, rritja e prodhimit në shtetet e EJL6-ës do të rritet në më pak se gjysmën (deri në 0.6 përqind) e parashikimeve bazë (prej 1.9 përqind); në vitin 2015, rritja do të ulet me një të tretën (deri në 1.7 përqind) e parashikimit bazë (2.6 përqind).

Kutia 3: Parashikimi dhe rreziqet globale

Ekonomia botërore parashikohet të përshpejtohet këtë vit, me ekonominë me të ardhura të larta të cilat pritet të marrin kthesën pesë vjet pas krizës globale financiare. Rritja globale e PBB-së parashikohet të zgjerohet me 2.9 përqind në vitin 2014 (përkundrejt 2.4 përqind në vitin 2013) dhe 3.4 përqind dhe 3.4 përqind përkatësisht në vitin 2015 dhe 2016. Pjesa më e madhe e përshpejtimit pritet të vijë nga shtetet me të ardhura të larta, ndërkohë që lehtësohet kacavjerrja e rritjes nga konsolidimi fiskal dhe pasiguria e politikave dhe rimëkëmbjet e sektorit privat konsolidohen më tepër. Rritja e shteteve me të ardhura të larta parashikohet të forcohet nga 1.3 përqind në vitin 2013 në 2.0 përqind në vitin 2014, dhe 2.4 përqind në vitin 2015 dhe 2016. Rritja në shtetet në zhvillim parashikohet të mbetet në nivelin e 4.9 përqind. Gjithsesi, ndërsa pjesa më e madhe e rajoneve operon shumë pranë kapacitetit të plotë, përshpejtimet e rritjes në shtetet në zhvillim priten të stabilizohen për shkak të reformave thelbësore që lehtësojnë ngërçet strukturore dhe rrisin produktivitetin. Rritja me e madhe e shteteve me të ardhura të larta dhe kërkesa më e lartë për importe do të sjellin një erë ndryshimi për eksportet e shteteve në zhvillim, të cilat duhet të ndihmojnë në kompensimin e kushteve më strikte globale financiare.

Rreziqet për shtetet në zhvillim janë kryesisht të lidhura me ndikimet nga tregjet ndërkombëtare financiare, parë përkundrejt dobësive të brendshme. Kushtet shtrënguese globale financiare gjatë pesë viteve në vijim ndërkohë që normalizohet politika financiare në ekonominë me të ardhura të larta nënkuptojnë dobësim të prurjeve dhe kosto rritëse të kapitalit. Në rast se niveli i interesit rritet shumë shpejt, ose nëse ka tërheqje të forta të prurjeve kapitale, ekonominë me nevojë të mëdha financimi të jashtëm, ose me shtrirje të shpejtë të kreditimit të brendshëm në vitet e fundit mund të vendosen nën trysni të konsiderueshme. Progresi relativisht normal i uljes së rezervës së SHBA-ve deri tani dhe fakti që dy momentet e trazirave financiare që prej mesit të 2013-ës nuk kanë shkaktuar ende ndikime negative të rënda në shtetet në zhvillim, në vetvete janë pozitive, duke sugjeruar që rreziqet e lidhura me këtë proces janë ulur krahasuar me një vit më parë. Por, përshtatja me kushtet më të shtrënguara globale financiare është ende proces në vijim dhe reagimi i tregut mund të jetë i ndryshëm lidhur me pikat kyçe që kanë të bëjnë me uljen e rezervës, si për shembull me kohën e politikës së parë për reduktimin e rezervës. Rreziqet e mospërputhshmërisë së monedhës nga nivelet e larta të borxhit publik (“mëkati fillestar” që i ka ndjekur dhe në krizat e mëvonshme) nuk lidhen me pjesën më të madhe të shteteve në zhvillim, përveçse me shtetet në zhvillim të Evropës dhe Azisë Qendrore. Po ashtu, nivelet e larta të zotërimit të tregjeve të bonove të brendshme nga të huajt në disa ekonomi i ekspozojnë këto shtete ndaj ndryshimit të ndjesisë së tyre. Investitorët institucionalë të cilët kanë stoqe të mëdha të borxhit në monedhën lokale deri tani i kanë ruajtur ekspozimet e tyre gjatë dy episodeve të fundit të paqëndrueshmërisë së tregjeve financiare. Një tjetër moment i rëndësishëm i përkeqësimit të rrezikut global është një mjedis ku vlerësimi i kreditimit të shumë shteteve në zhvillim mund të çojë në tërheqje nga këto tregje, të cilat do të kenë implikime negative për aksesin në kapital dhe në kostot e kapitalit.

Konvergimi sfidues afatgjatë

Standardet e jetesës në EJT janë goxha më poshtë sesa standardet e jetesës në BE dhe që prej vitit 2000 ka pasur një rritje modeste të standardeve në EJT. Për më tepër, recesioni i dyfishtë e ka ngadalësuar progresin e arritur përpara krizës. Matur në kushtet e blerjes, të ardhurat mesatare në EJT6 në vitin 2013 kanë qëndruar në më pak se një të tretën e BE-së (Figura 43). Për më tepër, me të ardhura mesatare mbi 20 përqind më të ulëta se të ardhurat në BE11, shtetet e EJT6-ës janë në kushte më të këqija se homologët e tyre të Evropës Lindore që janë pjesë e BE-së.

Nivelet e rritjes mesatare në periudhën nga viti 2000 në vitin 2013 kanë qenë të pamjaftueshme për të siguruar konvergjim të qëndrueshme me standardet e jetesës së BE-së. Në këtë periudhë, nivelet e rritjes mesatare për frymë kanë qenë nën 3 përqind në vit, krahasuar me 1.1 përqind në shtetet e BE-së dhe 3.2 përqind të shteteve të BE11-ës. Si rezultat, pavarësisht diferencës së madhe të të ardhurave, EJT6-a e ka ngushtuar hendekun e saj me BE-në nga 24 përqind të mesatares së të ardhurave të BE-së në vitin 2000 deri në 31 përqind në vitin 2013 – një konvergjim mesatare prej rreth 0.5 përqind në vit (Figura 44). Kjo performancë është e kundërta e performancës në shtetet e BE11-ës, mesatarja e të ardhurave të të cilave u rrit nga 30 deri në thuhetse 40 përqind të mesatares së BE-së përgjatë kësaj periudhe, me një nivel më të shpejtë konvergjimi prej 0.7 përqind në vit. “Makineria e konvergjimit të BE-së” duket se po shpejton konvergjimin e të ardhurave në shtetet e reja anëtare të BE-së në ritëm më të shpejtë sesa në shtetet jashtë BE-së, edhe ndërsa këto të fundit bëhen shtete kandidate.¹⁷

Performanca e rritjes së EJT-së ka qenë më e ngadaltë se performanca e shteteve të Evropës Lindore veçanërisht gjatë dhe pas krizës globale. Megjithatë mbi 20 përqind më të ulëta, standardet e jetesës u rritën më ngadalë se në shtetet e BE11-ës në periudhën 2009 dhe 2013, me të ardhura mesatare që kanë rënë nga 81 në 78 përqind të shteteve të BE11.

Figura 43: PBB-ja për frymë në vitin 2012
GDP, PPP, 2005 USD






Figura 44: PBB-ja e EJT-së për frymë (PPP) si % e mesatares së BE-së



Burimi: Treguesit e Zhvillimit të Botës

¹⁷ Raiser, Martin; Gill, Indermit S. 2012. *Golden Growth : Restoring the Lustre of the European Economic Model*. Washington, DC: Banka Botërore. 2012. *Raporti i Rregullt Ekonomik i BE11-ës nr 25 Temë e Posaçme*. Washington, DC: Banka Botërore. © World Bank.

Figura 45: Konvergimi i të ardhurave (PBB-ja për frymë, PPP, 2005 USD)



Burimi: Staf i Bankës Botërore.

Arritja e standardeve të jetesës së BE-së kërkon dekada përpjekjesh të qëndrueshme nga EJT6-a, si dhe përmirësim të performancën e politikave, performancën institucionale dhe ekonomike. Edhe po të arrinin një rritje ekonomike prej 6 përqind në vit, do të duheshin dhjetë vjet që të kapej ritmi i shteteve të BE11-ës dhe mbi 20 vjet për të arritur standardet mesatare të jetesës të BE-së (Figura 45). Nëse do të merrnin si nivel krahasues një nivel më realist rritje prej 4.5 përqind, megjithëse dhe kjo rritje është në mënyrë të dukshme më e lartë se mesatarja e rritjes kohët e fundit, shteteve të EJT-së do t'u duhej 20 vjet të arrinin standardet e jetesës së BE11-ës dhe konvergimi me BE-në në tërësi është mundësi e largët.

Cilët faktorë ka të ngjarë të shtyjnë makinën e konvergimit ekonomike të shteteve të EJT6-ës? Një analizë e kohëve të fundit reflekton eksperiencën e shteteve anëtare të BE-së dhe tregon se zgjerimi i potencialit të rritjes

nëpërmjet reformave strukturore në një mjedis të qëndrueshëm makroekonomik çon në përshpejtimin e rritjes së konvergimin e të ardhurave.¹⁸ E përkthyer për situatën e shteteve të EJT6-ës, kjo do të thotë se heqja e pengesave strukturore në përzjerjen e politikave makroekonomike (siç u diskutua në pjesën e mëparshme të raportit), rritja e integritetit global, përmirësimi i potencialit dhe i konkurrueshmërisë produktive të ekonomisë dhe forcimi i institucioneve do të ndikonte pozitivisht në rritjen e të ardhurave dhe në konvergjim.

Rritja e të ardhurave në kuadrin afatmesëm deri në afatgjatë me synim arritjen e konvergimit me standardet e BE-së nuk nënkupton thjeshtë ruajtjen e ritmit të reformave, por dhe konvertim të përfitimeve të tyre në rritje të shëndetshme dhe të barabartë ekonomike. Po dëshmohej se të dy këto elementë janë të vështirë për t'u realizuar. Ritmi i reformës duket se është ulur gjatë krizave financiare, ndërkohë që shteteve u duhet të përfitojnë nga rimëkëmbja ekonomike për rinisjen e reformës dhe për proceset e konvergimit. Ka prova që sugjerojnë që përmirësimet në klimën e biznesit duhet të jenë me spektër të gjerë, dhe jo të drejtuar ndaj sektorëve specifikë, pasi rritja dhe kompanitë që hapin vende të reja pune kanë tendencë të jenë të reja dhe dinamike, por jo të përqendruara në ndonjë sektor specifik.¹⁹ Përmirësimi i lidhjeve tregtare lidhur me logjikën, institucionet dhe rregulloret është e rëndësishme për të përfituar nga tregu i BE-së. Për më tepër, qeveritë duhet të ofrojnë procese të besueshme dhe të harmonizuara të cilat garantojnë respektimin e standardeve të sigurisë së BE-së për firmat eksportuese, në veçanti për eksportuesit bujqësor. Përmirësimet në standardet e qeverisjes, duke përfshirë dhe shtetin e së drejtës, lidhen ngushtë me procesin e integritetit të BE-së. Por, reformat që kërkojnë nga BE-ja do të ndihmojnë po ashtu për inkurajimin e rritjes ekonomike në shtetet e EJT-së.

¹⁸ Raiser, Martin; Gill, Indermit S. 2012. *Golden Growth : Restoring the Lustre of the European Economic Model*. Washington, DC: Banka Botërore. Banka Botërore. 2012. *BE11 Raporti i Rregullt Ekonomik Nr. 25 Temë e Veçantë*. Washington, DC: Banka Botërore. © World Bank.

¹⁹ Arias, O. et al. 2013. *Back to Work: Growing with Jobs in Europe and Central Asia*, Banka Botërore, Washington, D.C.

Reformat e tilla janë të domosdoshme për rritjen e kërkesës për punë, uljen e papunësisë, trajtimin e sfidave të shkaktuara nga ndryshimet demografike (Kutia 4) dhe përmirësimin e prosperitetit në të gjithë EJL6-ën. Rritja e punësimit është shumë e rëndësishme për uljen e varfërisë dhe për zhvillimin në shtetet e EJL6-ës. Përderisa burimi kryesor i të ardhurave për pjesën më të madhe të familjeve është “shitja” e punës së tyre, rritja e mundësive për punësim dhe marrja e masave që punonjësit të kenë aftësitë e nevojshme për të përfituar nga këto mundësi janë shumë të rëndësishme për të rritur të ardhurat e 40 përqindëshit të mbetur të shoqërisë²⁰.


²⁰ Banka Botërore, 2014; Raporti i Rregullt Ekonomi nr. 5; Temë e veçante “Komentet Fillestare për Prosperitetin e Përbashkët”, Banka Botërore, Washington D.C.

Kutia 4: Sfidat demografike ndaj konvergimi të të ardhurave në EJL6

Reforma dhe konvergimi në EJL6 do të bëhen më të vështirë me moshimin e popullsisë. Me kalimin e kohës, kjo do të thotë se do të ketë më pak punonjës për të kontribuar për më shumë njerëz të dalë në pension. Për pasojë, është i rëndësishëm krijimi i një mjedisi biznesi që i inkurajon firmat të rekrutojnë dhe një mjedis social që e inkurajon popullsinë me moshë pune të kërkojë punë. Në të njëjtën kohë, qeveritë duhet të sigurojnë se investohen burime të mjaftueshme në arsim për të siguruar një krah pune me aftësi dhe produktiv kur të forcohet kërkesa e sektorit privat.


Çështjet e lidhura me zhvillimet demografike janë përkeqësuar për shkak se shtetet e EJL6-ës nuk bëjnë punë të mirë lidhur me tërheqjen e emigrantëve. Në fakt, e kundërta është e vërtetë. Shtetet e EJL6-ës janë kampionë në eksportimin e njerëzve. Diferenca ndërmjet shteteve të EJL6-ës dhe BE-së lidhur me migracionin është mbresëlënëse (Figura B4.1). Niveli i largimit të punonjësve me aftësi të larta nga shtetet e EJL6-ës është më i larti i agregatëve rajonalë evropianë (Figura B4.2). Në kuadrin e zhvillimit të ekonomive të EJL6-ës drejt novacionit dhe teknologjisë mund të identifikohen mangësisë në aftësi, të cilat mund të kufizojë rritjen ekonomike në rajon. Krijimi i stimuljeve për kthimin e individëve me aftësi për tregun e punës mund të bëhet shpejt përparësi për ekonomitë e EJL6-ës.

Figura B4.1: Niveli i migracionit në rajon



Burimi: Banka Botërore

Figura B4.2: Nivelet e migracionit të njerëzve me arsim të lartë



Burimi: Banka Botërore

III. Momente të Rëndësishme

Momenti i Rëndësishëm 1: (Pa)Punësimi i të rinjve në Ballkanit Perëndimor

Punësimi i të rinjve është i rëndësishëm

Shtetet e EJT6-ës kanë ndërmjet niveleve më të larta të papunësisë së të rinjve në Evropë, ndërkohë që papunësia tek të rinjtë ka goditur rëndë për shkak të krizës. Në nivelin e 49.2 përqind, papunësia mesatare e të rinjve në shtetet e EJT6-ës është thujse dyfish më e lartë se në shtetet e BE11-ës (27.1 përqind) dhe në shtetet e BE17²¹ (25.3 përqind)²². Nga të tetë shtetet evropiane me nivelet më të larta të papunësisë tek të rinjtë me mbi 40 përqind, pesë i përkasin Evropës Juglindore, ku përjashtim nga grupi bën vetëm Shqipëria (Figura S1.1). Shteti me performancë më të keqe lidhur me papunësinë e të rinjve është Bosnja dhe Hercegovina më 62.8 përqind. Papunësia tek të rinjtë u rrit më shpejt gjatë krizës globale financiare në EJT sesa në shtete të tjera, megjithatë rezultati u shkaktua nga disa shtete të mëdha. Nga periudha 2008 deri në 2012, niveli i përgjithshëm i papunësisë në BE është rritur me rreth 4 pikë përqindje duke arritur mbi nivelet para krizës dhe me 5 pikë përqindje në shtetet e EJT6-ës. Nivelet e papunësisë tek të rinjtë janë rritur dy herë më shpejt (Figura S1.2).

Figura S1.1





Figura S1.2

Youth unemployment has risen faster than adult unemployment since the crisis
change in unemployment rate, 2008-12 (percentage points)



Luftimi i papunësisë tek të rinjtë është i rëndësishëm. Jo vetëm që papunësia tek të rinjtë është rritur më shpejt dhe në nivele më të larta sesa papunësia tek të rinjtë si pasojë e krizës, por shtrirja e saj në kohë mund të çojë në rrezikun unik të krijimit të një “brezi të humbur” punonjësish me mundësi të vogla punësimi dhe me potencial të ulët ekonomik. Për më tepër, papunësia tek të rinjtë ka tendencë të jetë strukturalisht e ndryshme nga papunësia tek të rriturit. Në shtetet e EJT6-ës dhe në ato të BE11-ës, papunësia tek të rinjtë ndryshon në shumë aspekte. Brezi i ri aktual është i pari që është arsimuar tërësisht pas tranzicionit, kështu ai sjell në tregun e punës një mentalitet të ri dhe aftësi të ndryshme nga ato të prindërve të tyre. Mosintegroimi i këtij brezi në krahun e punës nënkupton që shtetet mund të humbasin brezin më produktiv.

Po ashtu, vijimësia e niveleve të larta të papunësisë tek të rinjtë përbën rrezik për rritjen afatgjatë ekonomike dhe kërcënon për rritjen e pabarazive dhe të tensioneve sociale. Kërkimet empirike tregojnë se papunësia e tejzgjatur në fillim të karrierës mund të ulë në mënyrë permanente fitimet në të ardhmen dhe


²¹ Shtetet e BE17-ës janë shtetet e BE15-ës, plus Qiproja dhe Malta. Me fjalë të tjera këto shtete janë: Austria; Belgjika; Danimarka; Qiproja; Danimarka; Finlanda; Franca; Gjermania; Greqia; Irlanda; Italia; Luksemburgu; Holanda; Portugalia; Spanja; Suedia; dhe Mbretëria e Bashkuar.

²² Të dhënat janë marrë nga 2012-a, në rast se nuk specifikohet ndryshe, për arsye përputhshmërie.

mundësitë për punësim, si dhe mund të çojë në vonesa ose humbje të akumulimit të aftësive që merren gjatë ushtrimit të punëve (ILO, 2012). Këto “efekte negative” mund të përkthehen në produktivitet më të ulët dhe në kapital njerëzor më të paplotë për këta punonjës të rinj më vonë në jetën e tyre, duke cenuar shumë rritjen potenciale të ekonomisë në të ardhmen. Papunësia e lartë tek të rinjtë është dëshmuar të ketë lidhje me rritje të pabarazisë së të ardhurave (Morsy, 2012) si dhe raste më të larta të palumturisë, të shfaqjes së problemeve mendore dhe të veprave penale (Bell dhe Blanchflower, 2009).

Së fundmi, në kuadrin e moshimit të shpejtë të popullsisë në të gjithë Evropën, papunësia e lartë tek të rinjtë në të gjithë Evropën përfaqëson po ashtu sfida të mëdha demografike dhe fiskale në kuadrin afatmesëm dhe afatgjatë. Deri në vitin 2030, përqindja e njerëzve me moshë 65 vjeç e sipër në popullsinë në moshë pune parashikohet të rritet ndjeshëm në shtetet e EJJL-së. Niveli i varësisë së personave të moshuar parashikohet të rritet shpejt (numri i të moshuarve krahasuar me numrin e njerëzve në moshë pune).

Figura S1.3: Numri i të moshuarve për dhjetë persona në moshë pune



Burimi: Staf i Bankës Botërore bazuar në të dhënat e Popullsisë të OKB-ës

në të ardhmen).


Në shtetet e EJJL-ës në vitin 2010 kishte mesatarisht 1.8 persona mbi moshën 65 vjeç për çdo 10 njerëz në moshë pune²³. Deri në fund të vitit 2030 për çdo 10 njerëz në moshë pune do të ketë 3 të moshuar. Disa shtete hasen me vështirësi (Figura S1.3). Bosnja dhe Hercegovina dhe Serbia parashikohen të kenë nivel posaçërisht të lartë të të moshuarve për dhjetë vetë në moshë pune. Për pasojë, shtetet e EJJL-ës nuk mund ta përballojnë mosangazhimin e të rinjve në tregun e punës. Kjo e bën uljen e papunësisë (së lartë) tek të rinjtë përparësi kryesore politikash, si lidhur me: (i) parandalimin e rënies dramatike të ofertës për punës dhe (ii) përballimin e kostos fiskale të pensioneve dhe të kujdesit shëndetësor (papunësia afatgjatë shkakton një shterim të konsiderueshëm fiskal mbi të ardhurat tatimore

Rritja Ekonomike është e nevojshme për të ulur papunësinë tek të rinjtë ...

Figura S1.4: Ndryshimi vjetor në nivelin e papunësisë tek të rinjtë dhe të rriturit kundrejt rritjes së PBB-së

²³ Përfshijtur Kosovën. Bazuar në të dhënat e Popullsisë së Kombeve të Bashkuara.

Papunësia tek të rinjtë duket se ka më shumë ndikim mbi rritjen ekonomike sesa mbi punësimin e të rriturve. Marrëdhënia e konstatuar ndërmjet ndryshimit vjetor të papunësisë tek të rinjtë dhe tek të rriturit kundrejt rritjes së PBB-së për të gjitha shtetet evropiane për të cilët ka të dhëna të disponueshme për periudhën 1980-2012 konfirmon pikëpamjen se papunësia tek të rinjtë ka tendencë të jetë “super ciklike” në natyrë (shih, për shembull, Ryan 2001), duke iu përgjigjur më shumë si tronditjeve pozitive dhe tronditjeve negative ekonomike sesa punësimi i të rriturve (Figura S1.4). Në Evropë, brenda devijimit të standardeve të shteteve përkatëse për rininë, papunësia është thujse tre herë më e lartë për këtë grup sesa për të rriturit (3.5 pikë përqindje kundrejt 1.4 pikë përqindje).



Burimet: WDI dhe ILO

Nivelet pozitive të rritjes janë më shumë të rëndësishme për punësimin e të rinjve në shtetet e EJL6-ës sesa në shtete të tjera evropiane. Në shtetet e EJL6-ës, një pikë shtesë përqindje në rritjen ekonomike e ul papunësinë tek të rinjtë me 0.85 pikë përqindje krahasuar me 0.29 pikë përqindje për punësimin tek të rriturit. Në shtetet e BE11-ës, një pikë shtesë përqindje në rritjen ekonomike e ul papunësinë tek të rinjtë me 0.64 pikë përqindje krahasuar me 0.27 pikë përqindje për punësimin tek të rriturit.

Plotësimi i hendeqeve të mëdha që ekzistojnë lidhur me papunësinë e të rinjve në shtetet e EJL6-ës dhe të BE17-ës është sfidë. Plotësimi i gjysmës së hendeqeve ndërmjet shteteve të BE17-ës dhe të EJL6-ës (bazuar në mesataret e kampionëve ekzistues, përkatësisht 17.4 përqind dhe 52.9 përqind) në 15 vjet do të kërkonte diferencimin e rritjes së PBB-së me mesatarisht 4.4 pikë përqindje për 15 vitet në vijim për shtetet e EJL6-ës dhe shtete të tjera të BE-së, pasi në vitin 2000 ky tregues ka qenë shumë më i ulët sesa kaq (shih seksionin e Sfidave Afatmesme të Konvergimit të këtij raporti).


... dhe aftësitë, arsimi dhe politikat e tregut të punës kanë rëndësi

Rreth gjysma e ndryshimeve në papunësinë e të rinjve në Evropë në periudhën 2007-2012 mund të shpjegohet me uljen e prodhimit, ndërkohë që pjesa tjetër i dedikohet ndryshimeve në politika. Politikat që duket se kanë ndihmuar për uljen e papunësisë tek të rinjtë gjatë krizave përfshijnë: (i) ndryshimet në sistemet arsimore drejt shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe matematikës; (ii) lehtësimi i lidhjeve më të mëdha ndërmjet kompanive të sektorit privat dhe institucioneve arsimore; dhe (iii) përfshirja e firmave private në zhvillimin e kurrikulës së degëve profesionale. Rezultatet theksojnë rolin kryesor që luhet nga ndërveprimi ndërmjet institucioneve arsimore dhe sektorit privat për të përshtatur aftësitë e të rinjve me nevojat e tregut të punës. Shtetet mund të mësojnë nga eksperiencia e njëri-tjetrit lidhur me llojet e politikave të tregut të punës dhe të arsimit që kanë më shumë rëndësi për të luftuar papunësinë tek të rinjtë. Të gjashtë shtetet e EJL6-ës, ku Sondazhet e Sipërmarrjes dështojnë se mesatarisht 13 përqind e firmave e identifikojnë “krahun e punës të arsimuar në mënyrë të papërshtatshme si pengesë kryesore për të bërë biznes”, mund të mbështeten në eksperiencën e pjesës tjetër të Evropës për të përmirësuar

Moment i Rëndësishëm 2: Huatë e këqija të EKL6-ës: Efektet, pengesat që kërkojnë zgjidhje dhe reformat²⁴

Bankat në shtetet e EKL6-ës kanë ndër nivelet më të larta të huave të këqija në botë. Raporti mesatar i huave të këqija në totalin e huave në rajon është 16 përqind. Në Figurën 2.1 më poshtë jepet një krahasim i niveleve të huave të këqija në shtetet e EKL6-ës me disa ekonomi të trazuara dhe me disa ekonomi të tjera më stabil.

Figura S2.1: Huatë e këqija të bankave



Burimi: FMN-ja dhe autoritetet kombëtare

Trajtimi në mënyrë efektive i huave të këqija është i rëndësishëm për shkak se volumet e tyre të mëdha krijojnë zvarritje të rritjes ekonomike. Huatë e këqija të cilat nuk janë pastruar nga sistemi bankar përfaqësojnë burime financiare të cilat janë kyçur në sektorë jofitimprurës. Kur bankat pësojnë humbje dhe kur ju nevojitet të mbulojnë huatë e këqija, kapaciteti dhe kapitali i tyre huadhënes ulet. Mbledhjet e vonuara të huave të këqija e pakësojnë likuiditetin e bankave duke çuar në kosto financuese më të shtrënguara dhe, në mënyrë të tërthorët, në nivele më të larta interesi për huatë e reja. Kjo e bën huamarrjen më pak të përballueshme për bizneset dhe për familjarët. Nivelet e larta të huave të këqija gjymtojnë rritjen ekonomike duke çuar në kujdes të tepruar ndërmjet huadhënësve. Në situatat ku disa banka vuajnë nga rritje të nivelit të huave të këqija, mund të shfaqen shqetësime sistematike rreth aftësisë paguese dhe mungesës së likuiditetit të sistemit bankar. Ky është një rrezik i veçantë për ekonomitë e vogla me sisteme bankare të përqendruara bankare, siç është rasti në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Në rast se çështja e huave të këqija nuk trajtohet siç duhet në mënyrë përfundimtare, rajoni mund ta gjejë veten të përfundojë i gozhduar në një periudhë stanjacioni të gjatë.

VI | CONTENTS Pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme (shih Tabelën S2.1), në rajon ka shumë pengesa për të ulur nivelin e lartë të huave të këqija. Këto pengesa përfshijnë: (i) mungesën e dëshirës nga bankat për të njohur humbjet “përfundimisht” nga huatë e këqija për shkak të ndikimit negativ në kapitalin e tyre; (ii) shumë nga bankat e huaja mëmë duhet të forcojnë bilancet e mbarë grupit, duke mos ushtruar kështu presion mbi degët për të njohur humbjet dhe për të vijuar punën; (iii) presioni rregullator nga disa autoritete mbikëqyrëse ka çuar në një qasje të varfët të

²⁴ Ky Moment i Rëndësishëm është nxjerrë nga: Banka Botërore. 2014. *Stabilitet i Brishtë*, Perspektiva e Sektorit Financiar në Ballkanin Perëndimor, Nr. 3, (që do të dale më vonë).

menaxhimit të kapitalit; (iv) restrukturimi kërkon bashkëpunim të kreditorëve, i cili rrallë është praktikuar në tregjet ku konkurrenca huadhënëse ka qenë e fortë në vitet para krizës; (v) kuadret ligjore të papërshtatshme për të mbështetur si veprimet vullnetare për zgjidhjen e huave të këqija (të cilat duhet të përfaqësojnë pjesën më të madhe të përgjigjeve) edhe zbatimin e masave që trajtojnë huatë e këqija (në ato raste ku bashkëpunimi i huamarrësit nuk ekziston).

Po ashtu duhet të theksohet dhe të forcohet roli i mbikëqyrësve bankarë për krijimin e stimuljeve për bankat për të ulur huatë e tyre të këqija dhe për të shmangur periudha të gjata të huamarrjes së papaguar dhe, për pasojë, rritje të dobët ekonomike. Bankat qendrore po përmirësojnë planet për përgatitjen për periudhat e krizave, po ka ende pika të dobëta në disa fusha, duke përfshirë monitorimin dhe politikëbërjen e kujdesshme në nivelin makro, procedurat për huamarrje emergjente, ndarjen e informacionit ndërmjet lojtarëve të sigurisë financiare, sigurimin e depozitave dhe kuadre për zgjidhje nga banka. Mbikëqyrja duhet t'u kërkojë bankave: (i) të respektojnë në mënyrë strikte standardet rregullatore për klasifikimin dhe provigjionimin; (iii) të marrin kapital të ri nga aksionerët nëse nuk kanë kapital të mjaftueshëm; dhe (iv) të ofrojnë stimujt e duhur për bankat për eliminimin e huave problematike aktuale brenda një kuadri të arsyeshëm kohor.

Tabela S2.1: Përmbledhje e Programeve dhe e Reformave në proces e sipër për të trajtuar huatë e këqija në Ballkanin Perëndimor

Lloji i Iniciativave/ i Reformave	Shqipëria	Bosnjë dhe Hercegovina	Kosova	Ish Rep. Jugosllave e Maqedonisë	Mali i Zi	Serbi
Hartat dhe planet e rimëkëmbjes nga huamarrësi	●	●	●		●	●
Rishikime të cilësisë së aseteve në banka		●			●	
Mbikëqyrje më e fortë	●			●	●	
Qasje kolektive për ristrukturimet e huave		●			●	
Reforma e falimentit / kuadri gjyqësor						●
Reforma e kuadrit ristrukturues vullnetar të huasë		●	●			●
Harmonizimi i çështjeve tatimore	●				●	
Harmonizimi i kodit civil për zbatimin e kolateralit	●					●
Përmirësimi i kuadrit ligjor për shitjet e shumicës së huave të këqija		●				●
Ofruesi kryesor i ndihmës teknike	Banka Botërore	FMN-ja	Banka Botërore		Banka Botërore	

Legjenda ● e ndërmarrë ose në proces ● në diskutim me FMN-në ● Në diskutim me Bankën Botërore

VI | **Banka Botërore, FMN-ja**

Në Ballkanin Perëndimor duhet të trajtohen pengesat ligjore për mbledhjen e huave të këqija dhe zgjidhjen e kësaj çështje. Këto pengesa ligjore përfshijnë:


- Mangësitë në procesin e mbledhjes së kolateralit. Shembuj të çështjeve të zakonshme përfshijnë: (i) procese gjyqësore që vendosin për shitjen e kolateralit të cilat vonohen me muaj të tërë, ose ndonjëherë dhe me vite për shkak të vështirësive për arritjen e procesit; (ii) zgjidhjet jo gjyqësore, të cilat lihen jashtë në mënyrë të

panevojshme për shkak të kërkesës për disa ankande (ndonjëherë dhe në kushte jo transparente) me zbritje të konsiderueshme nga vlera e vlerësuar e kolateralit; (iii) vonesa në ekzekutimin e barrëve mbi asetet e lëvizshme për shkak të taktikave evazive të huamarrësve.

- Mangësitë në kuadrin ligjor për ristrukturim vullnetar jashtë gjykate dhe në trajtimin tatimor, të cilat pengojnë zgjidhjen e një huaje të keqe. Problemet e zakonshme përfshijnë: (i) huatë e këqija nuk trajtohen si shpenzime të zbritshme për huamarrësin; (ii) shitja e huave (normale ose të këqija) (ndonjëherë për koleksione të posaçme ose për një agjenci faktorimi) është objekt TVSh-je, ose i tatimit të transferueshëm në vlerën e plotë të huasë së mbetur; (iii) krijimi i një aktiviteti të tatueshëm nëpërmjet faljes së borxhit, ose nëpërmjet teknikave të tjera strukturore; (iv) paaftësia për zbritjen e humbjeve në këmbimin e një huaje me një kapital kur ka diferencë ndërmjet vlerës së huasë dhe vlerës së “kapitalit” të aksioneve të marra; dhe (v) paaftësia për ta trashëguar humbjen në kuadrin e shkrirjeve dhe blerjeve.

Shtojcë: Treguesit Kryesorë


Figura AI. 1: PBB-ja Reale: Ndryshimi në përqindje që prej pikut para krizës



Sbënim: 2013 tregon vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.


Figura AI. 2: Parashikimet e rritjes Reale të PBB-së, 2014



Sbënim: 2013 tregon vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.


Figura AI. 3: Niveli i Papunësisë



Shënime: Kosova që prej vitit 2012.

Burimi: Llogaritjet e Bankës Botërore.


Figura AI. 4: Bilanci Fiskal



Shënim: 2013 tregon vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.

Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.


Figura AI. 5: Borxhi Publik



Shënim: 2013 tregon vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.


Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Figura AI. 6: Rritja e Eksporteve




Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Figura AI. 7: Rritja e Importit



Burimi: Llogaritjet e Bankës Botërore.


Figura AI. 8: Bilanci i Llogarive Korrente



Shënim: 2013 tregon vlerësimet e stafit të Bankës Botërore.


Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Figura AI. 9: Rritja e depozitave dhe e kreditimit Privat




Burimi: Llogaritjet e stafit të Bankës Botërore.

Figura AI. 10: Huatë e Këqija



Burimi: Bankat qendrore.

Figura AI. 11: Lehtësia e të bërit biznes



Burimi: Të Bërit Biznes.